

të fëmijëve në transmetimet
mesën e Autoritetit të Med
ive që prej muajit prill ka
itur më **Buletini** shumë se
mendime **Lëshillit** për su
ë cilave kanë **Ankesave.** N
të drejtë të kërkojë, të heto
të marrë dhe të ndajë infor
dhe ide, pa asnjë lloj censu
adidos, tu dhe mjeteve të tjer
ikimit audioviziv apo ndon
e tjetër bazuar në përsqjed
m nëse këtë e bën në kuadër
timin të sundin
tave të njeriut. **MM**
i me krijimin e shërbimeve



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

Dërbajtja

Parathënie	04
Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave	09
SEKSIONI I	
Ankesa me subjekt cenimi i të drejtave të fëmijëve	12
SEKSIONI II	
Ankesa me subjekt cenimi i rregullave të etikës dhe dinjitetit	23
SEKSIONI III	
Ankesa të tjera	33
SEKSIONI IV	
Rekomandime dhe Peticione	39
SEKSIONI V	
Ankesat të rrëzuara	44

Parathénie

DY FJALË NË VEND TË HYRJES

Etika në media trajton parimet dhe standardet specifike, mbrojtjen dhe rekomandimin e koncepteve të sjelljes së drejtë dhe të gabuar. Media është mjete që mundëson shpërndarjen e informacionit/ dijes drejt një pluraliteti marrësisht ose shfrytëzuesish pa dallim. Në të gjithë botën ne e dimë se komuniteti i fuqishëm i medias punon me një ritëm të jashtëzakonshëm për të qenë në pararojë të lajmit apo zhvillimit teknologjik. Në të gjitha platformat e gazetarisë mediat konkurrojnë ashpër për pjesën e tregut dhe të audiencës. Megjithatë, shumë njerëz, përfshirë edhe ata që punojnë në media, ndihen të shqetësuar se në këtë atmosferë të mbingarkuar tensioni për të kapur informacionin më të fundit, por njëkohësisht për të ruajtur dhe standardet e gazetarisë dhe ato që rregullojnë median, gazetaret e pranojnë se gjenden nën një presion të vazhdueshëm. Dhe kjo atmosferë nuk është kurrë më shumë e evidente se në Ballkanin Perëndimor, një rajon që ka njohur konflikte të gjata dhe jeton beteja të përhershme për çështje si të drejtat e njeriut apo parime e rregulla që kanë të bëjnë me proceset demokratike të një vendi.

Shërbimet në tërësi që ofrojnë subjektet audiovizive mbështeten në kuadrin ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar të çdo vendi, bazuar mbi praktikën më të mira dhe standardet perëndimore, të cilat progresojnë me kohën. Në të shumtën e rasteve këto rregulla apo norma morale dhe etike shpesh mbulojnë një spektër të gjerë të fushash.

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive është një strukturë që mbikëqyr zbatimin e Kodit të Transmetimit të miratuar nga AMA sa i përket dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet audiovizive. Dhe bazuar mbi këtë mbikëqyrje të tërë çështjesh që kanë të bëjnë me etikën, Këshilli i Ankesave çdo 6 muaj boton një përmbledhje të përfundimeve të nxjerra në një buletin të veçantë.

Ndërsa në buletin e parë kemi ngritur si çështje kryesore mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, bazuar mbi numrin e shumë të ankesave të ardhura me këtë përmbajtje, në buletin e dytë të Këshillit të Ankesave janë publikuar më së shumti shqyrtime ankesash ku pretendohet se cenohet dinjiteti njerëzor. Bazuar mbi numrin e ankesave dhe sa i përket përmbajtjes së tyre, një çështje për t'u shenjuar në këtë buletin të ri, është pikërisht respektimi i dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut.

Çështja e respektimit të dinjitetit të njeriut, një "e drejtë njerëzore", shkakton shpeshherë jo pak debate në mediat audiovizive. E nëse do të ndryshonim logjikën e këtij konteksti mund të shtojmë gjithashtu se, dhe vetë mediat kanë gjithë fuqinë e botës të ndikojnë nëpërmjet programeve të tyre në respektimin e kësaj të drejte.

E vërteta është se thelbi i këtij parimi është ende i vështirë për t'u kuptuar e trajtuar nisur nga rastet, madje më shumë se sa ai i së drejtës për informacion dhe i lirisë së shprehjes. Rastet e shqyrtuara dhe gjykimi i tyre ndihmojnë gjithmonë e më shumë në përmirësimin e situatës së trajtimit të këtyre çështjeve, duke u mbështetur kryesisht tek rrengjet ligjore dhe elementet kryesore që përbëjnë atë që është përcaktuar si normë apo rregull etik- **respektimi i dinjitetit njerëzor**, duke aplikuar që këtej standarde të kënaqshme në shërbimet audiovizive.

Trajtimi dhe vendimmarrja për mjaft raste të pretendimit të cenimit të të drejtave të qytetarëve nga Këshilli i Ankesave ka pasur vëmendjen parësore. Në ankesat e trajtuara gjatë këtij gjashtëmujori janë parë disa precedentë me mjaft rëndësi për mirëfunksionimin e medias audiovizive. P.sh. një rast është ankesa e qytetarit me inicialet N.K., i cili shkroi AMA-s se materiale të tij, video të hedhura në rrjetet sociale, po përdorshin pa lejen e tij në një media audiovizive, e për më tej, duke e satirizuar personin dhe cenuar dinjitetin e tij.

Këshilli i Ankesave i dha të drejtë qytetarit, duke i kërkuar medias mospërdorimin e materialeve filmike, të cilat kishin cenuar një prej parimeve themelore të Kodit të Transmetimit, përkatësisht pikën 1.3, ku thuhet se "Transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut". Trajtimi i kësaj ankese dëshmoi një precedent të domosdoshëm për të trajtuar raste të ngjashme në të ardhmen, por edhe për të vendosur një standard që asnjë material vetjak të mos përdoret nga media audiovizive pa marrë lejen e autorit.

Nisur nga rastet e cenimit të dinjitetit, Këshilli i Ankesave ka trajtuar ankese me të tilla përmbajtje në shumicën e rasteve, tepër sensibilizuese, për të cilat ka marrë vendime deri në organizimin e seancave dëgjimore. Edhe pse bëhej fjalë për çështje familjare dhe mjaft problematike, Këshilli i Ankesave ka ruajtur qëndrimet e tij parimore, duke i dhënë të drejtë qytetarit për të mos u identifikuar, por edhe vetë medias që kërkon të trajtojë raste që kanë interes publik, siç mund të jetë çështja e pronave.

Në Ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sanksionohet e drejta e përgjigjes nga çdo qytetar. Aktualisht AMA ka miratuar rregulloren "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes", e bashkë me të, ka hyrë në fuqi edhe udhëzimi përkatës që rregullon procedurën për këtë të drejtë.

Për njohje si më poshtë:

- E drejta e përgjigjes mund të kërkohej nga çdo person, dinjiteti dhe reputacioni i të cilit janë prekur nga publikimi i fakteve dhe informacioneve jo të sakta në një transmetim.
- Personi që kërkon të drejtën e përgjigjes duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim, drejtuar OSHMA-së, për të cilin pretendohet se ka transmetuar fakte dhe informacione jo të sakta.
- Kërkesa duhet të përmbajë arsyet dhe faktet me të cilat provon pretendimet e tij.

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave ka ndërhurë në më shumë se një rast kur qytetari duhet të marrte përgjigje nga media mbi publikimin e një informacioni të pavërtetë.

P.sh., një rast për t'u shënjuar ka qenë ai i një qytetari, i cili kërkonte që një emision televiziv në një media të korigjonte informacionin që kishte publikuar mbi disa të dhëna personale të tij, ndërsa të ftuar për të folur pikërisht për të, ishte vetëm njëra palë e paraqitur. Këshilli i Ankesave i dha të drejtë shqetësimit të tij dhe i kërkoj OSHMA-së përkatëse që të respektojë të drejtën e përgjigjes për çdo qytetar. Kërkesa e Këshillit të Ankesave u respektua nga OSHMA-ja dhe qytetari pati mundësinë t'i vihet në vend dinjiteti i nëpërkëmbur, me publikimin e fakteve jo të vërteta.

Kjo procedurë, që nënkupton të drejtën e përgënjeshtimit sa herë që lajmi apo programi publikon të dhëna të pasakta, do të vazhdojë të nxitet më tej nga Këshilli i Ankesave në mënyrë që komunikimi i qytetarëve me subjektet audiovizive jo vetëm të arrijë disa standarde minimale të njohjes së problemeve mes tyre, por dhe të rrisë besueshmërinë e pushtetit të medias tek publiku, meqënëse këto kohë është tronditur maksimalisht.

Etika në media është një çështje parësore sa i përket hapësirës ligjore ku ajo shtrihet dhe asaj që media duhet të reflektojë. Shqipëria po kalon një periudhë të vështirë veprimtarie në të cilën gjendet pushteti i katërt. Dhe autoritetet rregullatore e paraqesin si sfidë të tyre, mbikëqyrjen e legjislacionit në fuqi, sidomos sa u përket çështjeve etike.

Në total, në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive kanë mbërritur 22 ankese nga institucione shtetërore, organizata joqeveritare dhe individë të ndryshëm. Këshilli ka vërejtur dhe shqyrtuar me kujdes të gjitha ankesat, duke i argumentuar përgjigjet e tyre dhe vendimet për to, bazuar mbi nenet dhe rregullat e hartuara në Ligjin për Mediat Audiovizive, nr. 97/2013.

Prej tyre, çështjet ankuese më sensitive kanë qenë ato rregulla dhe parime, shkelja e të cilave përbën cenim të të drejtave të të miturve dhe fëmijëve në transmetimet audiovizive. Kujtojmë se Kodi i Transmetimit, ndër parimet themelore të tij, ka garantimin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtën e tij për privatësi. Nga dhjetëra ankesa, shumica e tyre kanë pasur për objekt shqyrtimi cenimin e të drejtave të të miturve, të cilave, Këshilli i Ankesave u është përgjigjur menjëherë duke u sjellë vazhdimisht në kujtesë operatorëve audiovizivë përmbajtjen e rregullave të Kodit të Transmetimit.

Ankesa të tjera janë regjistruar, disa prej tyre me përmbajtje cenimin e rregullave etike në transmetimet audiovizive, cenimin e dinjitetit dhe privatësisë, ankesa të konsideruara të rrëzuara, të cilat nuk kanë qenë kompetencë e Këshillit të Ankesave dhe, si rrjedhojë, u janë kaluar Drejtorive të tjera në AMA, në rastet konkrete Drejtorisë së Mbikëqyrjes. Gjithashtu, në adresë të Këshillit të Ankesave kanë mbërritur ndër të tjera Rekomandime dhe Peticione lidhur marrjen e masave për zbatimin e Kodit të Transmetimit; si dhe ankesa që nuk janë konsideruar të tilla, bazuar mbi rregullat dhe aktet nënligjore të përfshira në Kodin e Transmetimit. Vendimet lidhur me këto ankesa janë marrë gjatë mbledhjeve që Këshilli i Ankesave ka kryer në 6-mujorin e parë të vitit 2017.

Anketimi janar 2017- qershor 2017

Anketimi i vitit 2017 mbi performancën e Kodit të Transmetimit në median shqiptare vjen më i plotë në të dhëna dhe përmbajtje. Pyetësi u organizua me 3 grupe të shpërndarë në terren, sipas zonave të konceptuara brenda kompozimit social; zonë qendrore, zonë periferike, zonë informale. Parë nga koncepti sociologjik i ndërtimit të sondazhit, kjo ndarje zonale është vlerësuar se përfaqëson më mirë sociologjinë e Tiranës së djeshme dhe të sotme.

Disa perceptime dhe rezultate

Lexuesit dhe të interesuari t do të njihen gjerësisht me rezultatet e anketimit në kapitullin e fundit të këtij buletini, megjithatë dëshirojmë të ndajmë disa nga gjetjet e tij. Në pyetjet e anketimit jepen rezultate mjaft interesante nga publiku mbi disa prej sfidave kryesore që ka media shqiptare sot.

P.sh. për pyetjen sa respektohen standardet e privatësisë në median audiovizive shqiptare, mesatarja e përgjithshme, pra me një vlerësim përfundimtar se privatësia ruhet dhe respektohet vetëm disi nga media. Kjo mesatare është edhe më e ulët në vlerësimin që jepen për pyetjen nëse mediat janë në mbrojtje të interesit publik.

Interesante paraqiten përgjigjet, duke marrë për bazë vlerësimin e qytetarëve në zonë gjeografike apo në bazë të arsimimit të tyre. Qytetarët e pyetur, që banojnë në qendër, japin vlerësimin më të ulët. Sa më afër qendrës dhe sa më i arsimuar, aq më mosbesues ndaj medias si mbrojtëse e interesit publik.

Pyetja se sa i pavarur është informacioni nga politika ka mesataren më të ulët. Qytetarët me arsim të lartë ose pasuniversitar e vlerësojnë me mesataren më të ulët, duke mos pasur pothuaj fare besim se informacioni është i pavarur nga politika.

Në pyetjen e parë se sa respektohen standardet e privatësisë në median audiovizive shqiptare, me vlerësimin me notë nga 1 në 7, mesatarja e përgjithshme është 3.75, pra me një vlerësim përfundimtar se privatësia ruhet dhe respektohet vetëm disi nga media. Kjo mesatare është edhe më e ulët në vlerësimin që jepen për pyetjen nëse mediat janë në mbrojtje të interesit publik. Sërisht, publiku vlerëson median në interes të publikut vetëm disi. Interesante mbeten përgjigjet duke marrë për bazë vlerësimin e qytetarëve në zonë gjeografike apo në bazë të arsimimit të tyre. Konkretisht, qytetarët e pyetur që banojnë në qendër japin vlerësimin më të ulët, me një mesatare prej 2.83, ndërsa të anketuarit me arsim pasuniversitar japin vlerësim edhe më të ulët, 2.43 pikë.

Mesatarja e përgjigjeve për respektimin e disa vlerave në media, si diversiteti kulturor, e drejta për informim, pluralizmi i ideve, mbrojtja e konsumatorit etj., kanë një vlerësim përgjithësisht me notën disi nga publiku, por gjithsesi më e lartë se të tjerat.

Në pyetjen se sa i pavarur është informacioni nga politika që marrim nga media ka mesataren më të ulët me 2.67, duke u vlerësuar me pak. Qytetarët në periferi dhe gjinia mashkullore japin vlerësimet më të ulëta dhe, nga ana tjetër, qytetarët me arsim të lartë ose pasuniversitar e vlerësojnë me mesataren më të ulët këtë përgjigje me 1.57.

Pyetjes nëse informacioni që jepet në media i shërben më shumë publikut apo interesave të ngushta të mediave, 74% e qytetarëve mendon se u shërben interesave të ngushta të medias dhe vetëm 16% e tyre mendon se i shërben pjesërisht publikut. Publiku jep një mesatare të moderuar kur pyetet për ndjeshmërinë e vërejtjeve dhe kritikave të publikut.

Një gjetje interesante e këtij anketimi është edhe reklama në media, duke njohur shqetësimin për reklamën e fshehtë. 67% e qytetarëve të pyetur mendojnë se ka reklamë të fshehur në median shqiptare. Po ashtu, ata japin mendimin e tyre se në cilin programacion i shohin këto reklama. Gjithashtu, anketimi ka edhe një vlerësim për reklamat dhe si i sheh ato.

Çështje të tjera me interesa janë edhe për prodhimet e pavarura, për kulturën evropiane dhe sa ndihet ajo në media, mbulimin e problematikave ndaj shtresave në nevojë, nivelin edukues të medias tek fëmijët, kujdesi për të mos krijuar paragjykime etj.

Në përfundim, gjetjet e këtij anketimi do të japin një kontribut thelbësor për politikë-bërjen, por edhe për vetë median në tërësi. Gjetjet e anketimit janë një mundësi shtesë për mediat në përmirësimin e vazhdueshëm të punës së saj. Në 20 pyetjet e anketimit jepen rezultate mjaft interesante nga publiku mbi disa prej sfidave kryesore që ka media shqiptare sot. Perceptimi i publikut shpesh surprizon me përgjigjet e tij edhe

edhe për disa tema, për të cilat mund të ketë një perceptim krejt ndryshe.

Procesi i trajtimit
të ankesave nga
Këshilli i Ankesave

Mbështetur mbi Ligjin nr. 97/ 2013 për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë dhe Kodit të Transmetimit, shikuesit dhe dëgjuesit e subjekteve audiovizive kanë të drejtën të ankohen rreth përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, nëse ata besojnë dhe mendojnë që subjektet kanë cenuar apo shkelur parimet dhe rregullat etike, të hartuara në Ligjin Nr. 97/2013 dhe ato në Kodin e Transmetimit.

Por që të mund të ngrihet një ankesë duhet të identifikohet më parë programi apo emisioni, të cilit ankesa i referohet, duke përfshirë datën dhe kohën e transmetimit. Gjithashtu, ankuesi duhet të shpjegojë se çfarë cenimi/shkelje ka vërejtur në përmbajtjen e programit që e ka detyruar atë të ngrejë një ankesë.

Është shumë e rëndësishme të përcaktohen qartësisht argumentet e një ankesë dhe përse materiali programor apo përmbajtja komerciale nuk pajtohet me parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikën e përcaktuara në Ligjin nr. 97/2013 dhe në Kodin e Transmetimit. Ligji për mediat audiovizive dhe Kodi i Transmetimit mund të gjenden në faqen zyrtare të AMA-s: www.ama.gov.al.

Në një nga seksionet e kësaj faqeje, pasi të klikoni në rubrikën "Formular ankesë për shkeljen e Kodit të Transmetimit", plotësoni formularin me të dhënat që kërkohen ose mund të shkruani në adresën zyrtare të AMA-s: info@ama.gov.al.

Në përputhje me procesin e ankimit, shikuesi apo dëgjuesi duhet të dërgojë ankesën në adresën që gjendet në fund të fletës së ankesës, pasi ka lexuar me kujdes udhëzimet për hartimin e saj, por mbi të gjitha parimet dhe rregullat e Kodit të Transmetimit.

Në disa raste, publiku vetë mund t'ua drejtojë OSHMA-ve ankesat që ai harton, kur e mendon se kjo është një rrugë më e shpejtë dhe që subjekti mund të reflektojë. Kur shikuesi apo dëgjuesi nuk mbetet i kënaqur me përgjigjen nga transmetuesit ose, nëse transmetuesi nuk përgjigjet, atëherë ai mund ta referojë ankesën e tij në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në faqen e tij zyrtare ose me postë.

Sa i përket trajtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave në shqyrtimin e çdo ankesë që i mbërrin, bazohet mbi kodet dhe rregullat përkatëse në ligj, në materialin e shkruar të paraqitur nga palët përkatëse, si dhe materialin e transmetimit. Ankesat shqyrtohen në nivel ekzekutiv nga Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të AMA-s, si Drejtoria e Programeve, Drejtoria Juridike dhe ajo e Mbikëqyrjes.

Detajet e shqyrtimit dhe vendimet mbi ankesat për përmbajtjen e transmetimeve audiovizive të marra nga Këshilli i Ankesave janë publikuar në këtë dokument, i cili quhet Buletini i Këshillit të Ankesave.

Vendimet merren mbi çështjen, nëse një program apo një komunikim tregtar ka apo nuk ka respektuar kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullat e Kodit të Transmetimit. Vendimet nuk lidhen me miratimin apo përkrahjen që mund t'u bëhet palëve në ankesë dhe gjithashtu ato nuk vijnë si rezultat i trajtimit të çdo aspekti të detajuar që përmban vetë ankesa.

Këshilli i Ankesave nuk kryen asnjë vlerësim të veçantë apo të pavarur jashtë çështjeve të parashtruara në ankesë.

Ankesa me
subjekt
cenimi i të
drejtave
të femijëve

Ankesa e paraqitur: **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Televizioni Top Channel	Edicion Informativ	25.05.2017
Televizioni News 24	Edicion Informativ	25.05.2017
Televizioni Ora News	Edicion Informativ	25.05.2017

1. Programi

Ankesa lidhet me publikimin e një lajmi në edicionet informative të këtyre subjekteve audiovizive, dy prej të cilave janë televizione informative që transmetojnë edicione informative 24 orë në 24 dhe vetëm një prej tyre është tradicionale. Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa është publikimi i të dhënave sensitive lidhur me rastin e një fëmije, viktimë e abuzimit seksual.

2. Kategoria

Ankesa parashtrohet mbi parimet e sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe Ligjin nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve", ku sanksionohet qartë ruajtja e konfidencialitetit dhe e privacisë së fëmijës. Ankesa bazohet edhe në Ligjin nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, miratuar në 27 janar 2014, seksioni "Parime Themelore", pika 1.4, 1.17 si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pika 5.1 (garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi).

3. Përmbledhje e ankesës

Nisur nga ngjarja e Beratit, ku drejtori i një shkolle dyshohet se ka ngacmuar seksualisht dy nxënese të shkollës që drejtonte, Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve shpreh shqetësimin për mënyrën se si ky rast është raportuar në mediat audiovizive.

Ankuesi vëren se tre televizionet - Top Channel, News 24 dhe Ora News - kanë publikuar lajmin në fjalë në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së fëmijëve. Edhe pse emrat e dy nxënësve që dyshohet të jenë ngacmuar apo abuzuar seksualisht nuk janë publikuar, identifikimi i tyre bëhet në mënyrë të tërthortë. Pasi është publikuar emri i plotë i drejtorit të shkollës, janë publikuar pamje nga shkolla, bashkë me emërtimin e saj, si dhe pamje nga klasa e 11-të që ndiqnin dy nxënëset, ndaj të cilave dyshohet se ka pasur abuzim. Për më tepër, gjatë publikimit të lajmit, janë intervistuar nxënës të tjerë të shkollës, moshatarë të dy nxënësve, viktimat të një abuzimi të dyshuar.

Bazuar sa më sipër, ankuesi vë në dukje se publikimi i lajmit mbi abuzimin seksual të dy nxënësve në mediat e sipërpërmendura përbën shkelje të të drejtave të fëmijëve, përfshirë këtu veçanërisht, të drejtën e konfidencialitetit dhe privatësisë së fëmijëve. Sipas Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, raportimi i ngjarjes nga këto media bën të mundur identifikimin në mënyrë të tërthortë të nxënësve viktimat, përmes publikimit të detajeve të sipërcituara. Ankuesi argumenton se informacione të tilla të bëra publike, që i bën fëmijët të identifikueshëm në rastet kur ato janë viktimë e një ngjarje të rëndë, ndikojnë në riviktimizimin e fëmijës dhe rehabilitimi i tyre më pas bëhet shumë më i vështirë.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialeve filmike, Këshilli i Ankesave konstatoi se të tre televizionet në fjalë e kanë publikuar lajmin, duke dhënë të plotë emrin dhe mbiemrin e drejtorit abuzues të shkollës, emërtimin e shkollës, duke publikuar pamje nga shkolla dhe nga klasa e 11-të, që ndiqnin dy nxënëset e dyshuara si viktimat të një ngacmimi dhe abuzimi seksual.

Këshilli i Ankesave, duke rikujtuar se kuadri legjislativ dhe rregullator për mediat audiovizive përcakton qartë përgjegjësitë e mediave ndaj respektimit të të drejtave të fëmijëve, thekson njëherazi se, OSHMA-të kanë detyrimin ligjor të ndalojnë transmetimin e programeve që çojnë direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar apo i akuzuar për kryerjen e një vepre penale.

Duke konsideruar Ligjin 97/ 2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" mbështetur në nenin 33, germa dh) dhe në Kodin e Transmetimit të AMA- s, seksioni 1, "Parime Themelore", pika 1.3, 1.4, 1. 17, si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pikat 5.1 dhe 5.2 ku përcaktohet qartësisht se: "OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale"; dhe po ashtu "duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare".

Këshilli i Ankesave konstatoi shkelje të Ligjit 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Kjo shkelje përsëritet më tej me intervistimin, me zë dhe pamje, të nxënësve të tjerë të shkollës, moshatare të nxënësve, të cilat dyshohet të jenë abuzuar nga drejtori i shkollës.

Këshilli i Ankesave konstatoi se, gjatë raportimit të këtij lajmi nuk janë respektuar as parimet e sanksionuara në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për të Drejtat e Fëmijës". Kjo Konventë, palë e së cilës është edhe Shqipëria, në nenin 16 të saj, "Mbrojtja e jetës private", thuhet shprehimisht: "Asnjë fëmijë nuk u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare apo të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose në korrespondencën e tij".

Ndaj, Këshilli i Ankesave e mbështeti ankesën e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, bazuar mbi përmbajtjen dhe argumentimin e saj ligjor, duke u fokusuar në aspektet e të drejtave të të miturve, e në veçanti, mbi ndikimin personal që këto publikime të detajuara cenojnë personalitetin psikomotor të fëmijëve më vonë. Identifikimi i tërthortë i dy vajzave, ndaj të cilave dyshohet të ketë abuzuar drejtori i shkollës, mund të shkaktojë dëmtime psikologjike me pasoja për të ardhmen e tyre dhe të pengojë rehabilitimin e tyre pas traumës së shkaktuar.

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive vendosi t'u tërheqë vëmendjen tre operatorëve audiovizivë, bazuar mbi Ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe në Kodin e Transmetimit të AMA-s, duke u rikujtuar gjithashtu se, mbrojtja e interesit më të lartë për fëmijën duhet të jetë parimi mbizotërues që duhet të udhëheqë punën e medias para çdo interesi tjetër.

Ankesa e paraqitur: **Ankesë e paraqitur nga: Znj. A. B.**

Dërguar në: info@ama.gov.al

Subjekti audioviziv

TV KLAN

Programi

Emision i përditshëm "Rudina"

Data

26. 01. 2017

1. Programi

Programi i pasdites "Rudina" është një program argëtues-informativo-kulturor që synon të promovojë situata sociale dhe kulturore, të cilat shërbejnë si shembull frymëzimi dhe modeli bashkëkohor në transmetuesin televiziv. Ai është një program i përditshëm që ka ruajtur një traditë të hershme, duke përbërë një nga shtyllat kryesore të audiencës në tregun audioviziv.

2. Kategoria

Ankesa është bazuar mbi cenimin e parimeve, rregullave, kërkesave dhe praktikave që përmban Kodi i Transmetimit në Republikën e Shqipërisë. I hartuar në zbatim të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, ankesa flet ashpër për shkelje të rregullave dhe normave të tij, bazuar në seksionin 1, Parimet themelore dhe seksionit 5, Fëmijët në transmetimet audiovizive.

3. Përmbledhje e ankesës

Qytetarja A. B. ka dërguar një ankesë në adresën zyrtare të faqes së AMA-s, info@ama.gov.al dhe shpreh shqetësimin për shkelje të etikës nga subjekti televiziv, pikërisht në emisionin e pasdites "Rudina", në të cilin qytetarja shpjegon se është folur për seksin dhe lojërat seksuale, shoqëruar edhe me video në orare jo të përshtatshme për një audiencë të përgjithshme, në të cilin ky emision transmetohet.

Nuk është aspak normale shkruan ajo, që me vendosjen e një logo (-16) të lind e drejta të transmetohen pa asnjë problem, materialet që u shfaqën në ekranet e televizioneve, duke e ditur që ai është një emision mjaft i ndjekur, për shkak edhe të orarit që transmetohet.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi materialin e transmetuar nga operatori audioviziv TV Klan dhe mendon se rasti në fjalë mbetet një shqetësim i drejtë. Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim materialin filmik të emisionit dhe konstatoi cenim të Kodit të Transmetimit bazuar në aktet nënligjore të tij. Pavarësisht vendosjes së shenjës paralajmëruese (-16), shkruhet në vendimin e Këshillit, paralajmërimit dhe kujdesit të treguar nga moderatorja në fillim të emisionit, demonstrimi i aksesoreve erotikë dhe lodrave seksuale në këtë fashë orari konsiderohen të papërshtatshme.

Këshilli i Ankesave, ndër të tjera, i ka kujtuar subjektit në fjalë se Kodi i Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, Seksioni 5,

"Fëmijët në transmetimet audiovizive", pika 5.32 thotë se "OSHMA-të duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik apo moral të fëmijëve, ose të marrin ndonjë masë tjetër teknike që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime. Ora kufi e përcaktuar për programe të tilla është 21.00–06.00". Në lidhje me parimet bazë të mbrojtjes të të miturve, siç janë garantimi i mbrojtjes dhe e drejta absolute e tyre, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive vendosi t'i tërheqë vëmendjen për të mos u përsëritur raste të tilla dhe ndër të tjera gjithmonë ka kujtuar se nuk duhet hequr nga vëmendja se në çdo transmetim, media duhet të konsiderojë mbrojtjen e interesit të fëmijës para çdo interesi tjetër.

Ankesa e paraqitur: **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë**

Subjekti audioviziv

Televizioni News 24

Programi

Emisioni "Me zemër të hapur"

Data

31.01.2017

1. Programet

Emisioni me "Zemër të hapur" është një program i përditshëm në trasmetimet audiovizive të këtij subjekti, ku trajtohen kryesisht ngjarje të vështira sociale me të cilat përballet publiku shqiptar. Qëllimi i këtij emisioni është publikimi i rasteve të ~~vështira sociale~~ sidomos për familjet në nevojë apo grupet vulnerabël. Shpeshherë aty ofrohen zgjidhje të situatës edhe për shkak se natyra e emisionit është e tillë, ku në qendër të këtij formati vendoset individi me problemin dhe përballë tij, janë palët që mund ta negociojnë çështjen.

2. Kategoria

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve shpreh shqetësimin se është konstatuar shkelja e të drejtave për mbrojtjen e fëmijëve, bazuar mbi parimet e sanksionuara në konventën e OKB-së "Për të drejtat e Fëmijës", Ligji nr. 10347 "Ligji për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve", Ligjin nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë, neni 33, Detyrimet e OSHMA-ve, pika e), si dhe Kodin e Transmetimit, Seksioni 5 Fëmijët në Transmetimet Audiovizive.

3. Përmbledhje e ankesës

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, në ankesën drejtuar Autoritetit të Mediave Audiovizive ka konstatuar se TV News 24, më datë 31.01.2017, ka publikuar në emisionin "Me zemër të hapur" rastin e një vajze 15-vjeçare që ~~ishte larguar nga shtëpia~~ për shkak të dhunës në familje. Nisur nga ky rast, ASHMDF e vlerësoi sensibilizimin e opinionit publik përmes medias lidhur me këtë situatë problematike, duke e referuar madje rastin në fjalë deri në strukturat e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Por nga ana tjetër, Agjencia megjithatë ngre shqetësimin për publikimin e të dhënave të së miturës 15-vjeçare. Ajo vlerëson që, edhe pse vajza nuk është ekspozuar përballë kamerave, gjatë bisedës me nënën e saj në studio, identifikohet emri i së miturës S.M. Identifikimi i saj është bërë i mundur edhe nëpërmjet intervistimit të nënës së vajzës me zë e figurë. Më tej, në ankesën e Agjencisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, shkruhet me shqetësim se si zakonisht pas transmetimit të këtij emisioni, lajmi është publikuar në portalet dhe mediat online me emrin e vajzës, pa kurrfarë mjeti mbrojtës, duke shtuar njëkohësisht se identifikimi i të miturës në media është në shkelje të të drejtave të fëmijës.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave e shqyrtoi me kujdes rastin në fjalë dhe konstatoi se emisioni “Me zemër të hapur” është transmetuar live në subjektin audioviziv, për të cilin po flasim. Nisur nga kjo, për drejtuesit e emisionit ka qenë e pamundur të korrigjohej në atë çast, nëna e vajzës që gabimisht publikoi identitetin e saj. Këshilli i Ankesave ka marrë kontakt menjëherë me drejtuesit e emisionit, duke u sugjeruar për të pasur më shumë vëmendje në emisione të tilla të ngjashme dhe sigurisht për të qenë korrekt me ligjin për median dhe parimet themelore të Kodit të Transmetimit, sidomos kur është fjala për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mes tyre, ruajtja e privatësisë dhe identiteti i të miturve.

Në përgjigjen dërguar subjektit televiziv është theksuar ndër të tjera se vërtet interesi publik për të trajtuar në media rastet e dhunës në familje është i madh, por kjo nuk duhet të na minimizojë rëndësinë që duhet t'i kushtojmë njëkohësisht dhe zbatimit të ligjit për të ruajtur etikën dhe të drejtat e grupeve vulnerabël apo të drejta të tjera.

Ndaj në këtë rast sugjerohet një tërheqje vëmendje për subjektin audioviziv, i cili duhet të jetë më shumë se i kujdesshëm në raste të tjera.

Ankesa e paraqitur: **Nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve**

Dërguar në: info@ama.gov.al

Subjekti audioviziv

Digitalb

Programi

Spot televiziv

Data

14.02.2017

1. Programi

Spoti televiziv është një reklamë, që ka në përmbajtje të saj një histori, aktorë dhe një mesazh. Ai synon të bindë shikuesit për përfitimet e produktit ose shërbimet që reklamuesi promovon.

2. Kategoria

"Observatori për të Drejtat e Fëmijëve", si një organizatë që ka në mision të punës së saj monitorimin e të drejtave të fëmijëve në të gjitha fushat e jetës, duke marrë shkas nga transmetimi i spotit më të ri televiziv të Digitalb-it ditën e Shën Valentinit, ka shprehur shqetësimin se është në shkelje të të drejtave të fëmijëve, bazuar në ligjin nr. 97 "Për mediat audiovizive në Shqipëri" dhe përkatësisht nenin 18 "për objektivat e veprimtarisë së AMA-s" pika 1/a, dhe nenin 19 "Për funksionet e AMA-s" pika 4 dhe nr. 33 "Për detyrimet e AMA-s" pika 1/e.

3. Përmbledhje

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve si një organizatë që ka në mision të punës së saj monitorimin e të drejtave të fëmijëve në të gjitha fushat e jetës, duke marrë shkas nga transmetimi i spotit më të ri televiziv të Digitalb-it, ditën e Shën Valentinit, ku janë realizuar skena shumë sensuale që sjellin atmosferën e filmit "Fifty Shades Darker" paraqet një ankesë bazuar mbi ligjin nr. 97 i vitit 2013 "Për mediat audiovizive në Shqipëri" dhe përkatësisht neneve nr. 18, pika 1/a, nr. 19 pika 4, nr. 33 pika 1 / e. Kjo organizatë, e cila në qendër ka mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, argumenton se spoti televiziv në fjalë, pa siguruar mbrojtjen e të miturve nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror, bie në kundërshtim me ligjin nr. 97 e veçanërisht me pikën 1/e të nenit nr. 33. Ndër të tjera, në ankesë theksohet se konsiderata për të kontribuar së bashku në një edukim më të mirë të fëmijëve në përputhje me të drejtat që janë përcaktuar ndër konventa ndërkombëtare mbetet prioriteti i tyre.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, pasi shqyrtoi ankesën që erdhi nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, një organizatë që ka në mision të punës së saj monitorimin e të drejtave të fëmijëve në të gjitha fushat e jetës, shqyrtoi materialin filmik të publikuar nëpërmjet spotit televiziv ditëve të festës së Shën Valentinit. Bazuar mbi ankesën e bërë nga Observatori, Këshilli konstatoi dhe e vlerësoi se skena e shfaqura ishin vërtet të palejueshme për një publik të gjerë, nëse ato nuk siguroheshin nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror, duke cenuar në këtë mënyrë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive pasi iu referua videos përkatëse u interesua pranë Drejtorisë së Programacionit në Digitalb për më shumë informacion në lidhje me shfaqjen e saj.

Prej tyre u mësua se videoja në fjalë nuk u publikua më, pak orë pas shfaqjes së saj, pasi publiku kishte reaguar menjëherë nëpërmjet rrjeteve sociale.

Me këtë rast, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s vendosi t'i tërheqë vëmendjen kompanisë mediatike Digitalb që të bëjë kujdes në publikime të tjerë, duke u kujtuar gjithashtu drejtuesve të saj disa prej parimeve të Kodit të Transmetimit, Seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", Reklamat dhe fëmijët, pika 5.21, ku thuhet se 'OSHMA- të nuk duhet të transmetojnë reklama që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve'.

Ndër të tjera është theksuar se raste të tilla nuk duhet të përsëriten më.

Ankesa e paraqitur: **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë**

Subjekti audioviziv

News 24

Programi

"Me zemër të hapur"

Data

20.02. 2017

1. Programi

Ankesa i referohet emisionit "Me zemër të hapur" që trajton tema sociale dhe familjare të aktualitetit në një televizion informativ. Ankesa lidhet me trajtimin e një dhunimi ndaj një vajze adoleshente, e cila akuzonte nënë e saj se kishte dashur ta drogonte e më pas të shfrytëzonte seksualisht. Objekti në të cilin ngrihet ankesa është publikimi i të dhënave sensitive lidhur me rastin e një të miture si dhe rrezikimin e sigurisë së saj.

2. Kategoria

Ankesa parashtrohet mbi parimet e sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve". Gjithashtu ankesa bazohet në Ligjin Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" (neni 33, germa dh); dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive miratuar në 27 janar 2014, seksioni 1 "Parime Themelore", pika 1.4, 1.17 si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pika 5.1 (garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi).

3. Përmbledhje e ankesës

Agjencia thekson se gjatë emisionit është publikuar emri dhe mbiemri i vajzës, duke bërë të mundur identifikimin e plotë të saj para publikut që, sipas saj, bie në kundërshtim me parimet e ruajtjes së konfidencialitetit dhe privatësisë për të miturit. Nga ana tjetër, Agjencia vëren se identifikimi i qartë i vajzës, e cila është ende fëmijë

(16 vjeçe) dhe publikimi i historisë së saj mund të bëhet pengesë për ri-integrimin e saj në të ardhmen. Edhe pse vajza është e shoqëruar nga babai dhe një psikologe, këto nuk janë arsye të mjaftueshme për intervistimin e vajzës në studio televizioni, lidhur me pretendimin e saj për abuzim nga ana e nënës. Nga ajo që duket në emision ka gjasa që i ati i fëmijës përdor ekranin dhe fëmijën për të "nxjerrë" inatin ndaj ish-bashkëshortes. Ndër të tjera kemi të bëjmë me një vajzë që ka qenë në rrezik shfrytëzimi seksual nga nëna, dhe, të identifikuar në media përbën rrezik për të ardhmen e tyre, shënon më tej Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Sipas Agjencisë, interesi publik për transmetimin e plotë të rastit nuk është i qartë. Pas kontaktit me punonjës të mbrojtjes së fëmijëve, ka informacion që rasti është në gjykim dhe Prokuroria po heton për rastin. Përderisa institucionet po ndjekin rastin dhe vajza që rrëfen historinë nuk duket se kërkon ndihmë nga media për ndonjë nevojë, historia e saj ka gjasa që, më shumë se në interes të fëmijës është në interes të rritjes së audiencës së emisionit. Sipas Agjencisë, do të kishte kuptim që rasti të bëhej publik nëse institucionet nuk janë përgjigjur apo nuk po e bëjnë punën e tyre, sepse në atë rast do të kishte interes publik.

Në përfundim, Agjencia mendon se historia e fëmijës në media po përdoret për arsye që nuk janë në interes të fëmijës dhe kërkon që të tregohet kujdes në transmetimin e historive të ngjashme ku në qendër janë fëmijët.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialeve filmike të emisionit, Këshilli i Ankesave konstatoi se ka shkelje të Ligjit 97/ 2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe të Kodit të Transmetimit të AMA-s.

Pavarësisht se publikimi i historisë së 16-vjeçares kishte për synim denoncimin e një tentative shfrytëzimi seksual të nënës ndaj vajzës së saj, dhe pavarësisht se biseda është kryer në prani të një psikologe dhe një prindi, nuk përligjet shkelja e Kodit të Transmetimit; identifikimi i plotë i fëmijës me zë dhe figurë, si dhe përdorimi i fëmijës në konfliktin mes dy bashkëshortëve.

Konkretisht, pika 5.1 e Kodit të Transmetimit përcakton se "OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një veprë penale";

Gjithashtu, pika 5.2 e Kodit të Transmetimit përcakton qartësisht se "duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare ". Publikimi në studio nga vajza e identifikuar e historisë familjare me "tradhti", "drogim me valium" dhe "tentativë për ta shfrytëzuar seksualisht" është në shkelje të plotë të Kodit të Transmetimit. Identifikimi i qartë i vajzës 16-vjeçare, ende e mitur, si dhe publikimi i historisë së saj mund të bëhet pengesë për ri-integrimin e saj në të ardhmen.

Për rastet e ngjashme, Kodi i Transmetimit të AMA-s detyron televizionet që "duhet të përdorin teknologjinë e përshtatshme që mundëson fshehjen e identitetit me pamje ose zë të figurës". Në këtë rast nuk është përdorur teknologjia, (ndryshimi i zërit dhe fshehja e fytyrës), siç e parashikon Kodi i Transmetimit.

Këshilli i Ankesave vendosi të tërheqë vëmendjen, si dhe rikujtoi mangësitë e vazhdueshme në pasqyrimin e mjaft informacioneve dhe të dhënave ku përfshihen fëmijët.

Ankesa e paraqitur: **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë**

Subjekti audioviziv

Klan

Programi

"Zonë e Lirë"

Data

22.02. 2017

1. Programet

Ankesa lidhet me shkeljen e etikës në emisionin "Zonë e Lirë, një emision argëtues i formatit talkshoë, të datës 17.02.2017. Objekti në të cilin ngrihet ankesa është shfaqja e pamjeve jo të përshtatshme, si dhe ritransmetimi i emisionit në një orar jo të përshtatshëm për fëmijët. .

2. Kategoria

Ankesa parashtrohet mbi parimet e sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve". Gjithashtu ankesa bazohet në Ligjin Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" neni 33, germa dh); dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës dhe materialit filmik të emisionit, Këshilli i Ankesave konstatoi se ka cenim të ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe të Kodit të Transmetimit të AMA-s.

Në emision ishte i ftuar edhe një 13-vjeçar, i cili performoi me një instrument muzikor. Në studio janë ftuar më pas dy kërcimtarë, të cilët, gjysmë të zhveshur, janë shfaqur me kërcime për të rritur (bellydance dhe striptizëm), në prani edhe të fëmijës. Prania e tij në studio në skena të tilla të papërshtatshme përbën cenim të të drejtave të fëmijëve gjatë transmetimit të programeve, të cilat kanë vijuar edhe me ritransmetimin e emisionit, të nesërmen (datë 18.02.2017), në një orar të papërshtatshëm, duke filluar nga ora 12:31 e në vijim.

3. Përmbledhje e ankesës

Agjencia raporton se gjatë emisionit ka qenë i ftuar dhe i pranishëm një fëmijë 13-vjeçar dhe më pas, janë ftuar dy kërcimtarë, të cilët kanë qenë të zhveshur dhe performuan "kërcime për të rritur" në prani të 13-vjeçarit, i cili ndodhej në studio duke ndjekur shfaqjen e papërshtatshme për moshën e tij. Sipas Agjencisë, shfaqje të tilla në prami të një fëmijë shkaktojnë dëmtime dhe ndikojnë negativisht në formimin e personalitetit të fëmijës.

Për më tej, Agjencia vëren se emisioni është ritransmetuar të nesërmen në një orar të papërshtatshëm, gjatë mesditës, kohë kur fëmijët e të gjitha moshave janë para ekranit.

Këshilli i Ankesave rikujtoi se Kodi i Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, Seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pika 5.32 detyron 'OSHMA-të të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik apo moral të fëmijëve, ose të marrin masa teknike që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime'. (Ora kufi e përcaktuar për programe të tilla është 21:00 – 06:00).

Për sa më sipër, duke pasur parasysh që emisioni "Zonë e lirë" ka reflektuar edhe në raste të tjera ndaj vërejtjeve për cenim të Kodit të Transmetimit, AMA vendosi t'i tërheqë vëmendjen për të mos përsëritur raste të tilla.

AMA kërkoi gjithashtu heqjen e videove përkatëse nga kanali zyrtar në Youtube.



Ankesa me
subjekt
cenimi i
rregullave
të etikës dhe
dinjitetit

Ankesa e paraqitur: **Studio Ligjore "Jurisprudenca"**

Nr. 1477 Prot.

Subjekti audioviziv

Televizioni Klan

Programi

**"E diela shqiptare"
"Shihemi në gjyq"**

Data

17.04.2017

1. Programi

Programi përfshin informacione të ndryshme nga vendi dhe bota, intervista dhe biseda në studio, etj. Ankesa lidhet me publikimin e një lajmi në edicionin informativ të këtij subjekti audioviziv. Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa është publikimi i të dhënave sensitive.

2. Kategoria

Ankesa bazohet në Kushtetutën e Shqipërisë, neni 23 i saj; në Ligjin Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"; në Ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit, neni 3 i tij; si dhe në Ligjin Nr. 10385/2011 "Për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve".

3. Përmbledhje e ankesës

Studioja Ligjore "Jurisprudenca", e cila përfaqëson znj. Z. D., pretendon se në datën 09.04.2017, në rubrikën "Shihemi në gjyq", pjesë e spektaklit "E diela shqiptare", janë paraqitur rrethana dhe fakte të pavërteta ndaj qytetares Z. D.

Duke shkuar përtej rastit që përfaqëson, studioja ligjore në fjalë kërkon ndalimin e programit "Shihemi në gjyq", pasi "është totalisht në kundërshtim me ligjin, nuk respekton parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive, si edhe nxit dhunën dhe intolerancën ndërmjet shtetasve".

Bazuar sa më sipër, Studioja Ligjore "Jurisprudenca" kërkon marrjen e masës sipas Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" për të mos lejuar transmetimin e emisionit "E diela shqiptare". Ankuesi pretendon se emisioni ka shkelur dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut, të garantuara në Kushtetutën e Shqipërisë dhe në të gjitha aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pas ankesës së paraqitur nga Studioja Ligjore "Jurisprudenca" shqyrtoi materialin filmik dhe konstatoi cenim të Kodit të Transmetimit të AMA-s, konkretisht të seksionit 2, "E drejta për privatësi në transmetimet audiovizive", si dhe të ligjit 97/2013, nenit 33, pika dh), që gjithashtu sanksionon të drejtën për privatësi.

Këshilli i Ankesave konstatoi identifikimin e tërthortë të palës ankuese, znj. Z. D. Pavarësisht se nuk vëren shkelje të dinjitetit dhe të të drejtave themelore të njeriut, Këshilli i Ankesave vlerëson se, identifikimi i tërthortë i znj. Z. D. krijon premisa për cenim të së drejtës për fshehtësi të jetës së saj private.

Kodi i Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në Seksionin 2, "E drejta për privatësi në transmetimet audiovizive", në pikën 2.1 shprehet: "OSHMA-të, në veprimtarinë e tyre audiovizive, duhet të respektojnë parimin se e drejta për lirinë e shprehjes nuk duhet të tejkalohet deri sa të cenojë të drejtën e individit për të mbrojtur privatësinë, të dhënat e tij personale, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Kjo është një e drejtë themelore e njeriut, e përcaktuar në Kushtetutën e Shqipërisë".

Po ashtu, edhe neni 33, pika dh) e Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" përcakton si një nga detyrimet e OSHMA-ve të drejtën e fshehtësisë së jetës private: "...Ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet: Të mos cenojë të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit në çdo program të transmetuar nga OSHMA-të dhe mjetet e përdorura për të realizuar këto programe".

Bazuar mbi Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodin e Transmetimit, AMA vendosi t'i tërheqë vëmendjen Televizionit KLAN.

Duke rikujtuar se kuadri legjislativ dhe rregullator për mediat audiovizive përcakton qartë përgjegjësitë e mediave ndaj respektimit të dinjitetit dhe të drejtave të tjera themelore të njeriut, Këshilli i Ankesave theksoi se, OSHMA-të kanë detyrimin ligjor të ndalojnë transmetimin e programeve që çojnë direkt apo indirekt në identifikimin e personave, duke shkelur privatësinë e tyre. Parimet themelore kërkojnë nga operatorët e shërbimit mediatik audioviziv, që gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, të respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut.

Ankesa e paraqitur: **Nga z. V. C.**

Nr. 3830 Prot.

Data	Programi	Subjekti audioviziv
Televizioni KLAN	Emision satiro- investigativ STOP	14.12.2016

1. Programi

Emisioni ka si strukturë të tij probleme të ndryshme të qytetarëve, të cilët kërkojnë zgjidhje për shqetësimet e tyre, si dhe tema sociale nga realiteti shqiptar. Emisioni transmetohet çdo ditë të javës nga e hëna në të premte ora 20:05. Ankesa lidhet me transmetimin e një pjese të titulluar "V. Cuko, mashtrim nën petkun e Dhomës së Tregtisë Shqipëri- Serbi". Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa është përdorimi i përcaktimeve denigruese për figurën e ankuesit dhe personalitetin e tij.

2. Kategoria

Ankesa ngrihet duke u mbështetur në Ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 33 Detyrimet e OSHMA-ve, (1), germa a), b), c) dhe c); dhe neni 53 E drejta e përgjigjes, (1, 4).

3. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi V. C. ka hartuar një ankesë ndaj TV KLAN për një pjesë të titulluar "Vladimir Cuka, mashtrim nën petkun e Dhomës së Tregtisë Shqipëri-Serbi". Sipas ankuesit, në këtë transmetim në mënyrë të pavërtetë është deklaruar se "A. R. është takuar rastësisht në kafe me shtetasin V. C. Ky i fundit i ka premtuar ta shërojë kundrejt pagesës 7000 euro, pasi V. C. është paraqitur si president i Dhomës së Tregtisë Shqipëri- Serbi", duke aluduar për "peshkim të viktimave nga mashtruesi".

Ankesa shpjegon më tej se ky informacion është krejt i pavërtetë, sepse, sipas tij, shoqata 'Dhoma Shqipëri-Serbi' ekziston realisht dhe është person juridik shqiptar, i regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Së dyti, në ankesë argumentohet se, V. C. është zgjedhur nga asambleja themeluese e anëtarëve dhe vazhdon të jetë edhe aktualisht Kryetar i kësaj organizate jofitimprurëse e, së treti, shtohet më tej në ankesë se, kurrë nuk ka patur 'prezantim të rastësishëm në kafe', sepse mbi të gjitha, denoncuesit A. dhe E. Rushani kanë qenë të pranishëm në ceremoninë zyrtare të themelimit të shoqatës, çfarë është e gjitha e fiksuar në fotografitë e rastit.

Motra e denoncuesit dhe bashkëshorti i saj, vijohet më tej në ankesën e ardhur pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, kanë qenë anëtarë themelues të kësaj organizate dhe, nisur nga kjo lidhje e afërt pune shkruhet më tej aty, provohet se njohja e denoncuesit me 'mashtruesin' sipas transmetimit në TV KLAN, nuk është rastësore në kafe, por familjare e në kuadër të bashkëpunimit në të njëjtën organizatë. Në ankesë theksohet gjithashtu se nga ana e drejtuesve të emisionit përdoren përcaktime denigruese për figurën e ankuesit dhe personalitetin e tij.

Më tej, konstatohen lehtësisht qëndrime informative dashakeqe e përbaltëse, pasi sipas tij, në vend që ai që akuzon t'i referohet regjistrimit të gjykatës shqiptare për organizatat jofitimprurëse, pala që akuzon i drejtohet për një informacion një tjetër organizate të pathemeluar ende, në tallje me ligjin apo duke paraqitur si të ligjshëm dhe thelbësor faktin nëse e njih apo jo ambasada serbe një organizatë jofitimprurëse shqiptare. Ankesa shkon më tej duke argumentuar se këto qëndrime janë absurde dhe nuk mund të transmetohen as në formën e shakasë.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Këshilli i Ankesave pranë tij, pasi është njohur me ankesën në fjalë vendosi të shqyrtojë materialin filmik të regjistruar për këtë subjekt audioviziv, të cilën pala ankuese e mbështet në Ligjin 97/2013 "Për mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", Neni 33, Detyrimet e OSHMA-ve, (1), germa a), b), c) dhe ç) në të cilin thuhet se: "Çdo person, dinjiteti dhe reputacioni i të cilit janë prekur nga publikimi i fakteve dhe informacioneve jo të sakta në një transmetim, ka të drejtën e përgjigjes", dhe Neni 53, E drejta e Përgjigjes (1, 4), ku shprehimisht shkruhet se "Personi që ushtron të drejtën e

përgjigjes, në përputhje me rregulloren, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim, drejtuar ofruesit përgjegjës të shërbimit mediatik, duke paraqitur arsyet dhe faktet që mbështetin kërkesën e tij".

Pas kësaj, Këshilli i Ankesave sa më sipër gjykoi se ankesa duhet t'i përcillet për trajtim të mëtejshëm subjektit audioviziv privat kombëtar TV KLAN, ku në bazë të nenit 53, (6), thuhet se "brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, vendos për ushtrimin ose refuzimin e së drejtës së përgjigjes dhe për këtë njofton me shkrim kërkuuesin".

Ankesa e paraqitur: **Nga A.B**

Dërguar në: info@ama.gov.al

Data

TV Channel 1 Shkodër

Programi

Film artistik

Subjekti audioviziv

27.06.2017

1. Programi

Film artistik i shfaqur në orare të papërshtatshme për publikun e gjerë, nisur nga përmbajtja e tij, që në shumë raste shënjohej si cenim i normave të etikës.

2. Kategoria

Ankesa i referohet një filmi me skena erotike dhe shprehje banale të përkthyer pa kujdes nga drejtorja e programacionit dhe të transmetuara pa shenjat paralajmëruese për moshat e mitura. Ankesa gjen bazë në ligjin për mediat nr. 97/2013 si dhe në aktet nënligjore të Kodit të Transmetimit. Në njohje të Kodit të Transmetimit, ankuesi e mbështet shqetësimin e tij në parimet themelore të veprimtarisë së transmetimeve audiovizive, në normat dhe kërkesat morale dhe etike të kësaj veprimtarie.

3. Përmbledhje

Në ankesë shfaqet shqetësimi se Televizioni TV Channel 1 në qytetin e Shkodrës në orët e hershme të mbrëmjes ka transmetuar një film më shprehje banale, i cili ishte i aksesueshëm edhe nga publiku i gjerë pa asnjë kufizim moshe. Në ankesë theksohet se kjo është një shkelje e pastër e rregullave të transmetuesve audioviziv sa i përket etikës dhe normave të sjelljes për shoqërinë shqiptare.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive ka marrë një ankesë nga një qytetar për transmetimin e një filmi në datën 27.06.2017, në orën 20:45 të mbrëmjes.

Sipas ankesës, filmi përmban gjuhë të rënduar bazuar mbi normat dhe rregullat etike të transmetimeve audiovizive.

Pas shqyrtimit të materialit filmik, Këshilli i Ankesave e pa të arsyeshme t'i referohej Kodit të Transmetimit për Mediat Audiovizive, në të cilin thuhet se transmetimi i filmave që mund të cenojnë apo dëmtojnë fëmijët duhet të jepen vetëm pas orës 21:00 dhe gjatë gjithë kohës e shoqëruar me shenjë paralajmëruese. Në pikën 5.42 të Kodit të Transmetimit thuhet se "Për programet që transmetohen në fashën orare 19:00 – 22:30, bëhet i detyrueshëm përdorimi i shenjave paralajmëruese për programet që cenojnë e dëmtojnë fëmijët". Në pikën 5.46 të tij përcaktohen edhe llojet e shenjave paralajmëruese;

"A. Shenjë paralajmëruese me ngjyrë të kuqe, për programe ose filma, që nuk duhet të ndiqen nga fëmijët, të cilat transmetohen vetëm pas orës 21.00, me skena të rënda dhune psikologjike e fizike, me skena seksi, me keqpërdorim të gjuhës, fjalorit dhe etikës së komunikimit.

B. Shenjë paralajmëruese me ngjyrë të verdhë, për programe ose filma, të cilat fëmijët duhet t'i ndjekin të shoqëruar nga të rriturit.

C. Shenjë paralajmëruese me ngjyrë të gjelbër, për programe ose filma me përmbajtje që mund të ndiqen nga të gjithë, përfshi edhe fëmijët".

Përsa më sipër, Këshilli i Ankesave vendosi t'i tërheqë vëmendjen subjektit audioviziv për zbatimin rigoroz të Kodit të Transmetimit, në veçanti me orarin dhe shenjat paralajmëruese.

Subjekti audioviziv

Televizioni Tema

Programi

Vështrim Kritik

Data

25.05. 2017

1. Programi

Ankesa lidhet me emisionin "Vështrim Kritik" në Tema Tv, një emision satirik. Objekti i ankesës është shkelja e dinjitetit, denigrimi i figurës dhe përdorimin e materialeve video pa autorizim nga shtetasi i prekur.

2. Kategoria

Ankesa parashtrohet mbi parimet e ligjit Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 33, si dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

3. Përmbledhje e ankesës

Shtetasi N.K paraqiti ankesë pranë Autoritetit të Medias Audiovizive mbi emisionin "Vështrim Kritik". Sipas ankesës, emisioni kishte denigruar e fyer dinjitetin dhe personalitetin, si dhe kishte keqpërdorur materiale video të shtetasit të publikuar në faqet e tij në rrjetet sociale.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Me marrjen e kësaj ankesë, Këshilli i Ankesave iu drejtuar me një kërkesë Televizionit Tema për vënien në dispozicion të materialeve filmike të disa transmetimeve të emisionit "Vështrim Kritik".

Nga shqyrtimi i materialit, video të transmetuar nga Tema TV, Këshilli i Ankesave konstatoi se ka shkelje të ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" si dhe të Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Gjatë emisionit ku përdoren materialet filmike, përdoren komente dhe titra fyese, si "paranormali", ndaj shtetasit N.K.

Referuar Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 33, për Detyrimet e OSHMA-ve, pika ç, thotë "të mos cenohet dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut". Kodi i Transmetimit përcakton në pikën 1.3 të tij se "Transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut", ndërsa në pikën 2.2 "OSHMA-të, në transmetimet e programet e tyre, nuk duhet të bëjnë publike imazhe, pamje, filmime, dokumente apo fotografi, që përmbajnë të dhëna personale apo cenojnë dinjitetin e individit, përveçse me miratimin e tij".

Përsa më sipër, Këshilli i Ankesave kërkoi heqjen e menjëhershme nga transmetimi dhe ritransmetimi të pamjeve filmike të shtetasit N.K. si dhe pamjet video duhet të hiqen edhe nga kanalet zyrtare të "Tema" Tv në rrjetet sociale dhe platformat e tjera në internet. Televizionit "Tema" iu bë e ditur se mosrespektimi i këtij vendimi do të shoqërohet me sanksione në përputhje me ligjin.

Ankesa e paraqitur: **Nga J.Ç**

Nr. 2298 Prot.

Data

News 24

Programi

Me Zemër të Hapur

Subjekti audioviziv

12.07. 2017

1. Programi

Ankesa i referohet emisionit "Me zemër të hapur" që trajton tema sociale dhe familjare të aktualitetit në një televizion informativ. Objekti i ankesës është korrigjimi i fakteve, shkelja e parimit të paanësisë si dhe cenimi i personalitetit.

2. Kategoria

Ankesa parashtrohet mbi parimet e ligjit Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", si dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

3. Përmbledhje

Shtetasi J. Ç. paraqiti ankesë pranë Autoritetit të Medias Audiovizive, duke kërkuar korrigjimin e informacioneve të dhëna gjatë një prej emisioneve "Me zemër të hapur".

Sipas ankuesit, në studio kanë qenë të pranishëm bashkëshortja e xhaxhait dhe vajza e saj, më të cilat ndodhet në një proces gjyqësor për çështje pronësie.

Shtetasi pretendon se gjykata ka përcaktuar detyrimet për secilën palë dhe këto detyrime nuk u evidentuan gjatë emisionit. Ky vendim u vu në dispozicion të Këshillit të Ankesave. Më tej ai ankohet se gjatë emisionit, të ftuarat kanë shpifur ndaj tij duke e akuzuar se ka korruptuar gjyqtarë e prokurorë, si dhe akuzohet për çështje të tjera. Ankuesi pretendon se drejtuesja e emisionit ka mbajtur qëndrim të njëanshëm, së pari, duke mos e njoftuar atë si palë e përfshirë (duke i hequr mundësinë për të paraqitur argumentet e tij) e së dyti, duke lejuar çdo koment në studio pa ndërhyrë.

Shtetasi pretendon se familja e tij ka pësuar tronditje nga ky emision, nisur nga fakti se jetojnë në një komunitet të vogël.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi ankesën e shtetasit J. Ç. duke nisur me materialin filmik. Fillimisht u evidentua se të ftuarat në studio akuzonin një shtetas me emër tjetër. Pas kërkesës, Këshilli i Ankesave kërkoi nga pala e interesuar dokumentacion ligjor që provon lidhjen me personin A. Ç. i cili përmendet gjatë emisionit. Në datën 09.07.2017, ankuesi vuri në dispozicion të Këshillit të Ankesave vërtetimin nga Bashkia e Pogradecit, ku vërtetohet se z J.Ç. ka ndryshuar emrin me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 30.04.1999, nga A në J, duke provuar lidhje farefisnore me të ftuarit në studion televizive.

Pas shqyrtimit të materialit filmik të emisionit, Këshilli i Ankesave konstatoi se ka një trajtim të njëanshëm të çështjes. Njëkohësisht, gjatë emisionit bëhen publike të dhëna personale që nuk paraqesin interes publik.

Referuar ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", nenit 33, për detyrimet e OSHMA-ve, pika b) thuhet se OSHMA-ja duhet "të sigurojë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme".

Njëkohësisht, në nenin 53 të ligjit, pika 10, thuhet se "Këshilli i Ankesave, brenda 15 ditëve nga paraqitja e një ankese për refuzimin e së drejtës së përgjigjes nga një OSHMA, shqyrton çështjen dhe, nëse e gjen të drejtë ankesën e bërë, i kërkon OSHMA-së korrigjimin e fakteve dhe informacioneve, në lidhje me personin e interesuar, në një mënyrë të ngjashme dhe kohë të njëjtë me atë të transmetimit objekt ankese, brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit".

Kodi i Transmetimit përcakton detyrimet ndaj OSHMA-ve që çdo informacion të jetë i vërtetë, i saktë dhe i balancuar si dhe që OSHMA-të duhet të respektojnë të drejtën e korrektimit të informacionit si dhe të drejtën e prezumimit të pafajësisë e të konfidencialitetit. Pika 4.14 e Kodit të Transmetimit përcakton se "OSHMA-të duhet të respektojnë të drejtën e korrektimit dhe të përgjigjes, si dhe të drejtën e prezumimit të pafajësisë e të konfidencialitetit".

Në këto kushte, Këshilli i Ankesave çmoi si të drejtë ankesën e z. J. Ç. dhe vendosi që t'i jepet e drejta për të paraqitur pretendimin e tij. Në një nga emisionet e radhës, ankuesi mund të paraqesë me shkrim pretendimin e tij pranë Televizioni News 24, i cili duhet të lexohet i plotë gjatë të njëjtit emision.

3



Ankesa të
tjera

Data

Televizioni Top Channel

Programi

"Big Brother Albania 9"

Subjekti audioviziv

21.05.2017

1. Programi

Programi është një reality shoë, që bashkon disa individë (femra dhe meshkuj) të jetojnë përkohësisht së bashku në një shtëpi, të ndërtuar posaçërisht, dhe të izoluar nga bota e jashtme. Gjatë qëndrimit të tyre në shtëpi, banorët e saj monitorohen vazhdimisht nga kamerat televizive të drejtpërdrejta, si dhe nga mikrofonë audio personale. Ankesa lidhet me nja nga përmbledhjet ditore të këtij programi dhe objekti i saj është diskriminimi i një komuniteti të caktuar.

2. Kategoria

Ankesa bazohet mbi rregullat e përgjithshme të Ligjit Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe mbi Parimet Themelore të Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Në të dy dokumentet ligjore të sipërcituar përcaktohen qartë detyrimet për ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive, ndër të cilët, ndalimi i programeve me përmbajtje që nxisin urrejtjen mbi baza gjinore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi.

3. Përmbledhje

Ankuesi pretendon se, një nga pjesëmarrësit në "Big Brother Albania 9", që transmetohej në Televizionin "Top Channel", është shprehur me fjalë diskriminuese ndaj komunitetit egjiptian. Sipas ankuesit, në përmbledhjen ditore për "Big Brother Albania 9" të datës 21.05.2017, televizioni në fjalë ka transmetuar fjalët e një prej banorëve, pa i vlerësuar ato si fjalë fyese dhe diskriminuese ndaj një komuniteti të caktuar.

Përmbledhja ditore, shkruan ankuesi, nuk është transmetim direkt, ndaj televizioni kishte mundësi për të mos i transmetuar fjalët diskriminuese, që janë në shkelje të Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pas paraqitjes së shqetësimit për përdorimin e gjuhës fyese dhe diskriminuese ndaj komunitetit egjiptian në përmbledhjen ditore të emisionit "Big Brother", shqyrtoi materialin përkatës filmik.

Këshilli i Ankesave evidentoi përdorimin e gjuhës fyese ndaj këtij komuniteti. Meqë transmetimi është një përmbledhje e programit dhe jo transmetim i drejtpërdrejtë, u jepte mundësinë redaktorëve të shmangnin gjuhën e përdorur nga një prej pjesëmarrësve në emision. Për më tepër, përmbledhja ditore transmetohet në një orar me shikueshmëri të lartë nga publiku.

Këshilli i Ankesave risolli në vëmendje se, sipas Ligjit Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe Kodit të Transmetimit të AMA-s, përdorimi i gjuhës diskriminuese përbën shkelje. Konkretisht, në nenin 32, pika 4 të ligjit për mediat thuhet se "OSHMA-të nuk transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi".

Gjithashtu, edhe në Kodin e Transmetimit, seksioni 1, "Parime Themelore", pika 1.12 thotë se "Transmetimet audiovizive të të gjitha llojeve respektojnë të drejtën e barazisë dhe mosdiskriminimit për çdo shkak të mbrojtur nga legjislacioni shqiptar", si dhe pika 2.10, "Në transmetimet audiovizive, respektimi i parimit të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale duhet të zbatohet pa diskriminuar për shkaqe si raca, mosha, aftësia e kufizuar ose çdo shkak tjetër të mbrojtur nga legjislacioni shqiptar".

Bazuar sa më sipër, Këshilli i Ankesave vendosi t'i tërheqë vëmendjen Televizionit Top Channel për të mos përsëritur më gjuhën fyese dhe diskriminuese në programet e mëtejshme.

Reagimi i Televizionit

Pas tërheqjes së vëmendjes, Televizioni Top Channel, përmes një shkrese drejtuar Autoritetit të Mediave Audiovizive, bënte të ditura masat e marra pas transmetimit të përmbledhjes ditore, ku një nga banorët e "Big Brother Albania 9" përdori gjuhë fyese dhe diskriminuese ndaj komunitetit egjiptian.

"Ju informojmë se Top Channel dhe Produksioni i 'Big Brother Albania 9' i ka konsideruar të padrejta dhe në kundërshtim me ligjin sjelljet e banorëve brenda shtëpisë së 'Big Brother', si dhe përmbledhjen e datës 21 maj 2017 të këtij programi. Si rrjedhim, Top Channel, në emisionin live të ditës së shtunë, për shkak se e ka konsideruar të rëndë ngjarjen, e ka nisur programin pikërisht me ngjarjet e datës 21 maj, ku u është komunikuar banorëve dënimi për sjelljet e tyre diskriminuese. Po ashtu, produksioni ka vendosur që 50% e buxhetit javor të banorëve të shkojë për qendrat/shoqatat në ndihmë të njerëzve me nevoja të veçanta. Moderatorja e programit është shprehur se imitimi i invalidëve është një sjellje shumë e rëndë dhe askush nuk duhet të përkrahë e të promovojë sjellje të tilla. Por përkundrazi t'i ndihmojë këto shtresa të shoqërisë. Banorët, jo vetëm gjatë mbrëmjes live të programit, por edhe më parë, pas reagimit të produksionit, kanë kërkuar ndjesë publike. Tema e ndërgjegjësimit dhe e dënimit të sjelljeve diskriminuese, e nxitur nga ngjarja e datës 21 maj, u diskutua në programin 'Fan Club', ditën e diel, më 28 maj 2017, në Televizionin Top Channel", thuhet ndër të tjera në reagimin e administratorit të Top Channel, znj. Vjollca Hoxha.

Ankesa e paraqitur: **Nga: Znj. E.M**

Dërguar në: info@ama.gov.al

Data

TV KLAN

Programi

Seriali Premierë "Ertugrul"

Subjekti audioviziv

25.01.2017

1. Programi

Ankesa e ardhur në adresën elektronike të Autoritetit të Mediave Audiovizive nga një qytetare shpreh shqetësimin se subjekti audioviziv TV Klan, nëpërmjet transmetimit të filmit "Ertugrul" jep skena të dhunshme dhe bën propagandë diskriminuese fetare.

2. Kategoria

Ankesa i referohet përmbajtjes së një seriali televiziv premierë në TV Klan, "Ertugrul", në të cilin nxitet dhuna dhe urrejtja ndërfetare. Qytetarja e ngre ankesën duke u mbështetur në Kodin e Transmetimit, Seksioni 1 Parimet themelore: (1.5, 1.13, 1.15) dhe Seksioni 5, Fëmijët në transmetimet audiovizive, Programet kulturore argëtuese, filmat dhe fëmijët: (5.29, 5.30, 5.38)

3. Përmbledhje

Qytetarja E. M. ka dërguar një ankesë në adresën zyrtare të faqes së AMA-s, info@ama.gov.al ku bën me dije se në TV Klan dhe pikërisht në serialin premier "Ertugrul", janë shfaqur skena të egra dhune duke nxitur urrejtjen dhe mes të tjerash nëpërmjet tyre bëhet propagandë mbi mjetet e terrorit, të cilat qytetarja i quan pjesë të ISIS. Sipas saj aty jo thjesht propagandohet feja islame, mbi të gjitha besimi i krishterë paraqitet me nota fyese dhe denigruese.

Zonja shpreh shqetësimin se cdo qytetar duhet të ngrejë zërin për këtë përmbajtje të palejueshme audiovizive përderisa shkel rregullat morale dhe etike të një shoqërie të emancipuar si e jona.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi materialin e transmetuar nga operatori audioviziv TV Klan dhe, nisur prej saj, mendon që rasti në fjalë mbetet një shqetësim i drejtë, por që përfshin një debat të gjerë me shumë aktorë brenda, në lidhje me cilësinë e transmetimeve audiovizive. Nisur nga kjo, Këshilli i Ankesave vëren se përmbajtja e filmit ka të bëjë me një skenar që i referohet një konteksti të caktuar historik, pikërisht shekullit të 13-të, kur në Evropë gjendeshin fiset mongole, të cilët krijuan Perandorinë Osmane. Ndaj, ne gjykojmë se këtë përmbajtje dhe rrëfim nëpërmjet skenarit të filmit nuk mund ta paragjykojmë.

Shqetësimi ankueses mbetet i drejtë dhe gjithsesi mbetet për t'u vëzhguar dhe debatuar më shumë në të ardhmen për këtë çështje. Duhet të mos harrojmë se shumë filma të prodhuara në Hollivud kanë pasur në përmbajtjen e tyre përshkrime të shumta historike epokale, si p.sh. inkuizicioni apo kryqëzatat.

Ankesa e paraqitur: **Shoqëria "Dompe Farmaceutici" s.p.a****Nr. 951 Prot.**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Klan**Reklamë****23.02. 2017****1. Programi**

Ankesa lidhet me shfaqjen e një reklame të një medikamenti, për të cilin pretendohet se nuk mund të shitet pa recetë e mjekut. Objekti i ankesës është ndalimi i dhënies së kësaj reklame.

2. Kategoria

Ankesa parashtrohet mbi parimet e ligjit Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", nenit 42, pika 6, ligjit për Barnat si dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

3. Përmbledhje e ankesës

Shoqëria "Dompe Farmaceutici" s.p.a infomoi Autoritetin e Medias Audiovizuale se nga data 1 shkurt 2017 televizioni Klan ka transmetuar një reklamë mbi një produkt farmaceutik, i cili zotërohej nga kjo shoqëri. Në ankesën drejtuar AMA-s, kjo shoqëri evidenton se ky produkt duhet të shihet vetëm me recetën e mjekut. Nisur nga ky fakt, shoqëria tërhoqi vëmendjen se në bazë në ligjit Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", nenit 42, pika 6, parashikon që "Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive për produktet farmaceutike ose trajtime mjekësore, që jepen vetëm me recetën e mjekut, janë të ndaluara".

Më tej, shoqëria farmaceutike shprehet e shqetësuar se pacientët mund të ekspozohen ndaj rreziqeve të sigurisë për shkak të informacionit të reklamës duke qenë se ky informacion nuk është në përputhje me atë që autorizohet për produktin, çka mund të ndikojë gjithashtu negativisht në perceptimin e profilit të sigurisë dhe efikasitetit të produktit referencë të barit edhe në tregtimin e tij.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Me marrjen e kësaj Ankesë, Këshilli i Ankesave iu drejtuar me një kërkesë për informacion Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, duke kërkuar një informacion të zgjeruar për produktin FANS, sipas përcaktimeve specifike të shoqërisë farmaceutike. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore vuri në dijeni AMA-n se të dhënat e përditësuara mbi barnat e autorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë gjenden në faqen zyrtare të Agjencisë; akbpm.gov.al në rubrikën "regjistri i barnave". Bazuar në informacionin e ardhur, Këshilli i Ankesave iu drejtua zyrtarisht Televizionit Klan duke e vënë në dijeni për ankesën e ardhur pranë AMA-s. Televizionit Klan iu vu në dispozicion përgjigja e informacion Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore e cila vë në dukje se, në zbatim të ligjit nr. 105/2014, datë 31.07.2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", i ndryshuar, të dhënat e përditësuara mbi barnat e autorizuara gjenden në adresën www.akbpm.gov.al, në rubrikën "Regjistri i barnave". Sipas regjistrit, produkti FANS, Granula për tretësirë orale x 80 mg, ketoprofen lizinë, ka si zotërues shoqërinë "Dompe Farmaceutici", dhe është i pajisur me autorizim tregtimi me nr. 402/22.09.2014. Ky produkt nuk është pjesë e listës së barnave që jepet pa recetë. Lista gjendet në rubrikën "Publikime", në adresën eëë.akbpm.gov.al. Bazuar në nenin 42 të Ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", pika 6, ku thuhet se "Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive për produktet farmaceutike ose trajtimet që jepen vetëm me recetën e mjekut, janë të ndaluara", Autoriteti i Mediave Audiovizive kërkoi heqjen e menjëhershme nga transmetimi të reklamës për produktin farmaceutik ANS, Granula për tretësirë orale x 80 mg.





Rekomandim

Mbi zbatimin e legjislacionit të transmetimeve Nga Komisionari për Mbrojtjen nga Diskriminimi

REKOMANDIM

Nr. 4 Prot.

Data

4.01.2017

Përmbajtja

Komisionari për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dërguar një shkresë me rekomandime mbi zbatimin e legjislacionit të transmetimeve audiovizive në adresë të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në të cilën thuhet se, KMD monitoron në mënyrë të vazhdueshme median audiovizive, për të parë se si transmetohen lajmet ku në qendër janë fëmijët dhe gratë. Duke marrë shkas nga ngjarjet tragjike që kanë ndodhur ditët e fundit, ndajmë me ju shqetësimin, shkruhet më tej, për mënyrën sesi media ka publikuar dhe transmetuar ngjarjet tragjike ku përfshihen fëmijët dhe gratë viktime. KMD thekson se të gjitha mediat audiovizive kanë shkëlur etikën në mënyrë të vazhdueshme, duke paraqitur detaje rreth vrasjes dhe keqtrajtimit të viktimeve, gra dhe fëmijë. Në transmetimin e lajmeve tregohen detaje rreth mënyrës sesi ngjarja ka ndodhur, të dhënave personale të viktimeve dhe rrethit familjar, të cilat nuk janë të nevojshme për publikun.

Komisionari për Mbrojtjen kundër Diskriminimit nënvizon se transmetimi i detajuar i rasteve të tilla shkakton ndikim negativ, nxit urrejtjen dhe paragjykimet mbi njerëzit dhe shtresat vulnerabël. KMD shton se në këtë formë të publikimit të lajmeve, media bëhet promovues i dhunës duke e tejkaluar misionin e saj të informimit. KMD kujton se publikimi i këtyre të dhënave vjen në kundërshtim të plotë me legjislacionin shqiptar, që sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi dhe të drejtat e fëmijëve për të qenë të mbrojtur.

Këto transmetime, sipas Komisionarit, vijnë në kundërshtim me Kodin e Transmetimeve, i cili në pikën 4.19 dhe 5.1 parashikon: "Ofruesit e shërbimit mediatik audiovizivë duhet të shmangin çdo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një veprë penale". Komisionari për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke i

vlerësuar si të papërshtatshme këto transmetime të mediave audiovizive, rekomandon që të shmanget transmetimi i detajeve, i mënyrës së kryerjes së veprës penale, të jetës personale, që sjellin pasoja psikologjike tek fëmijët, viktimat e abuzuara, familjarët e viktimeve etj; të merren masa ligjore për mediat që kanë shkëlur legjislacionin e transmetimeve audiovizive, ndërsa media vetë duhet të rrisë ndërgjegjësimin e opinionit publik e të promovojë një qasje pozitive për grupet vulnerabël në mënyrë që të minimizohet diskriminimi dhe paragjykimi në krijimin e stereotipeve.

Përgjigja e hartuar nga Këshilli i Ankesave dhe Drejtoria Juridike dhe e Licencave

Në vijim të shkresës me nr. 1198 prot., datë 30.12.2016, administruar në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) me nr. 4 prot., datë 04.01.2017, në të cilën Komisionari për Mbrojtjen nga Diskriminimi pati dërguar rekomandime mbi zbatimin e legjislacionit të transmetimeve, Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe të Licencave informon me anë të një shkrese- përgjigje, si më poshtë:

... Sikurse ju kemi bërë me dije me shkresën nr. 3444/ 1 prot., datë 17.11. 2016, AMA, në zbatim të kompetencave dhe të dhëna prej Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ka ndërmarrë masa ligjore në rastet e konstatimit të cenimit të dispozitave të ligjit të sipërcituar dhe të Kodit të Transmetimit. Pavarësisht sa më sipër, AMA, duke vlerësuar se respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve janë ndër parimet themelore të veprimtarisë audiovizive, mbetet e hapur në trajtimin e rasteve konkrete ku evidentohet shkelja e parimeve të mësipërme prej ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive.

Ankesa e paraqitur: **SHOQATA ORL**

Nr. 4 Prot.

Përmbajtja

Data

Peticion

06.02. 2017

Shoqata shqiptare e Otorinolaringlogjisë dhe Shërbimi Universitar i ORL ka dërguar një peticion në adresë të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), në të cilin përshkruhen me shqetësim të madh disa trajtime të patologjive që kryhen në këtë specialitet nga një mjek i huaj i punësuar pranë Poliklinikës Gjermane. Mjeku I.S. i kryen këto trajtime dhe, sipas peticionit, ai punon prej disa vitesh pranë kësaj poliklinike duke aplikuar trajtime në disa sëmundje të hundës, sinuseve dhe të fytit.

Në peticion shkruhet se këto trajtime nuk i njej fare literatura, ndërkohë që prej tij dhe poliklinikës ku ai punon ato propagandohen si bashkëkohore. Shoqata e ORL-së përshkruan se në literaturën bashkëkohore të Otorinolaringlogjisë, ky trajtim me ultratinguj nuk ekziston si terminologji, ndërkohë që për secilën nga këto sëmundje ka një protokoll trajtimi shkencor që aplikohet nga mjekët specialistë dhe njihet nga literatura.

Konkretisht për trajtimin e polipeve të hundës aplikohet kirurgjia endoskopike funksionale e sinuseve, për korrigjimin e perdes së hundës kryhet septoplastika, për sinusitin kronik kirurgjia endoskopike dhe për infeksionin kronik të bajameve kryhet heqja e tyre dhe në asnjë nga këto sëmundje, shkruhet më tej në peticion, nuk përmenden në literaturë ultratingujt si alternativë trajtimi. Sipas specialistëve që kanë nënshkruar peticionin, ky mjek i kryhen këto ndërhyrje me një aparat që prodhohet në Greqi dhe pretendon se kryhen ndërhyrje pa gjak dhe pa dhembje, pa bisturi duke mashtruar pacientët dhe duke i shkaktuar atyre, dëmtime të pakorrigjueshme në hundë dhe në fytyrë.

Ndërhyrjet e pretenduara prej këtij pseudomjeku, vazhdon më tej peticioni, zgjasin vetëm 2 minuta, ndërkohë që një ndërhyrje sipas protokolleve shkencore zgjat nga 1- 2 orë dhe kryhen nën anestezi gjenerale.

Është normale, shkruhet më tej aty, dhe dihet tashmë ndikimi që kanë mediat në opinionin publik aq më tepër kur bëhet fjalë për shëndetin, dhe këta mjekë sharlatanë e shfrytëzojnë këtë duke i paraqitur këto metoda trajtimi si bashkëkohore, duke i çorientuar pacientët për të marrë një vendim të saktë për trajtimin shkencor të tyre. Jo më larg se para një viti, bëhet me dije në përmbajtjen e këtij peticioni, se një pacient vdiq tek një nga spitalet private në Tiranë. Ai trajtohej nga një sharlatan i tillë, me sodë buke për kancerin e stomakut.

Shoqata shqiptare e ORL-së ,duke marrë në konsideratë ankesat e shumë të sëmurëve që janë trajtuar nga ky mjek, si dhe shqetësimet e mjekëve ORL, shpreh bindjen se këto metoda trajtimi apo sharlatanizma në dëm të shëndetit të pacientëve, dëmtojnë imazhin e mirë të Otorinolaringlogjisë shqiptare, duke hedhur poshtë metodat shkencore që përdoren në të gjithë botën për trajtimin e këtyre patologjive.

Në peticionin dërguar AMA-s, bëhet thirrje të merren masa që këta mjekë sharlatanë të mos depërtojnë në sistemin shqiptar shëndetësor dhe të mos japin shërbime mjekësore që nuk pajtohen me protokollet shkencore. Bashkëngjitur këtij peticioni janë të gjitha firmat e mjekëve

Përgjigjja

Këshilli i Ankesave e mori në shqyrtim rastin në fjalë dhe vendosi ta trajtojë atë, së bashku me Drejtorinë e Programacionit pranë Autoritetit të Medias Audiovizive. Në një takim dypalësh u ra dakord, që Dr. Fatmir Brahimajt, President i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, t'i dërgohet një kërkesë për informacion ku Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) duke konfirmuar marrjen e një anekese nga Shoqata Shqiptare e Otorinolaringologjisë, shprehet se aty jepen vlerësime mbi performancën e një mjeku të huaj, punësuar në Poliklinikën Gjermane në Tiranë.

Më tej, aty shkruhet se, duke qenë se qëndrimet e këtij mjeku janë bërë publike dhe në median audiovizive, AMA është duke e shqyrtuar këtë rast me prioritet. Problemi që ngrihet në peticionin e nënshkruar nga shumë specialistë, ka aspekte që lidhen drejtpërdrejtë me shëndetin publik. Ndaj dhe në kërkesën për informacion, është shënuar që të jepen disa vlerësime të palëve në këtë çështje, meqenëse Urdhri është një strukturë zyrtare e fokusuar në zbatimin e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, në gjykimin disiplinor profesional, etj.

5



Ankesa të
mënyshme

Subjekti audioviziv

News 24

Programi

Edicion informativ

Data

12.06. 2017**1. Programi**

Ankesa lidhet me një çështje në gjykim dhe shtetasja kërkon materialet filmike, pas marrjes së një përgjigjeje negative nga News 24. Objekti i ankesës është marrja në përdorim të materialeve filmike të transmetuara.

2. Kategoria

Ankesa parashtrohet mbi parimet e ligjit Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", si dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

3. Përmbledhje e ankesës

Shtetasja H.Z paraqiti ankesë zyrtare pranë Autoritetit të Medias Audiovizive, duke kërkuar materialet filmike mbi një edicion informativ të transmetuar në News 24.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave informoi shtetasen se në bazë të nenit 37 i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton se: "OSHMA-ja, me mjetet e pajisjet e veta dhe në një mënyrë të përcaktuar për këtë qëllim nga AMA, duhet të mbajë katalogun e programeve dhe të regjistrojë çdo transmetim apo program të ofruar prej tij, në përputhje me licencën ... Regjistrimet e bëra në përputhje me pikën 1 të këtij neni duhet të ruhen nga OSHMA-ja për një periudhë 3-mujore".

Në nenin 52 të ligjit nr. 97/2013 të sipërcituar, parashikohen afate konkrete për formën si dhe afatet e paraqitjes së ankesës. Konkretisht, pika 2 e këtij neni përcakton: "Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë".

Për sa më sipër, kërkesa është jashtë afateve të përcaktuara nga ligji.

Ankete mbi
performancën e Kodit
te Transmetimit në
transmetimet audiovizive

Anketimi i vitit 2017 mbi performancën e Kodit të Transmetimit në median shqiptare vjen më i plotë në të dhëna dhe përmbajtje. I konceptuar nga Këshilli i Ankesave dhe ekipi i pedagogëve, ai u realizua nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit të Universitetin e Tiranës, i cili zbatoi metodologjinë dhe punën në terren për realizimin e anketimit.

Një falënderim shkon për kreun e Departamentit, As.Prof. Dr Mark Marku dhe gjithë ekipin e tij të pedagogëve e të studentëve, të cilët punuan me profesionalizëm, duke dhënë kontributin e tyre në trajtimin teorik dhe të përmbajtjes së anketimit.

Metodologjia

Pyetëtori për matjen e performancës së Kodit të Transmetimit u zhvillua në datën 5 korrik 2017, me 3 grupe të shpërndarë në terren, sipas zonave të konceptuara brenda kompozimit social; zonë qendrore, zonë periferike, zonë informale.

Në konceptin sociologjik të ndërtimit të sondazhit, kjo ndarje zonale është vlerësuar se përfaqëson më mirë sociologjinë e Tiranës së djeshme dhe të sotme. Shpërndarja e pyetësorëve në numër ka qenë e barabartë, nga 60 për çdo zonë. Në total janë plotësuar 180 pyetësorë nga grupet e punës, të përbërë nga një pedagog monitorues dhe 4 studentë, në total 12 studentë.

Zonat ku janë zhvilluar sondazhet janë "Komuna e Parisit", "Myslym Shyri", "Rruga e Elbasanit", ndërkohë që tek zonat periferike, ka pasuar shpërndarje të barabartë midis Laprakës dhe zonës së Kombinatit, ndërsa si zonë informale me njëfarë uniformiteti në kompozimin e saj është marrë si Bathorja.

Përmbajtja e pyetësorit

Në ndërtimin e pyetësorit ekipi i punës ka mbajtur parasysh të gjithë parametrat e Kodit të Transmetimit, duke ndjekur njëtrajtshmërinë e dokumentit, por duke i kombinuar me pyetje të ndërmjetme perceptive, si konsiderata të përgjithshme, më tepër për të thithur qëndrimin e publikut të sonduar mbi çështje që kanë të bëjnë me sa garantohet interesi publik nga mediat, i lidhur direkt me performancën e Kodit për rregullimin e aktivitetit të mediave. Ka pasur 3 modele të pyetjeve; pyetje të konceptuara me vlerësim me notë, pyetje me përgjigje të selektuara, ku propozohen alternativa përtej asaj që ofron Kodi i Transmetimit, si dhe pyetje me mundësi plotësuese, me përgjigje të padiktuara nga pyetja, por që i jepnin lirinë të sonduarit të propozonte përgjigje.

Vështirësitë

Vështirësia më e madhe kishte të bënte me stabilizimin e një gjuhe të divulguar për sondimin dhe për të sonduarit, ku si metodologji është ndjekur përdorimi i fjalëve kyçe zëvendësuese, më të thjeshtuara, dhe që mund të ndihmonin sonduesit për t'ia përshtatur gjuhën në parametra shumë më të thjeshtë. Për të ndihmuar këtë proces janë zhvilluar disa seanca test të pilotuara, për t'i kapërcyer këto vështirësi, pasi interesi final ishte që, teknikisht t'i qëndronim sa më besnik parametrave të Kodit, me pasojën që në raportim të kishim një gjuhë të rakorduar me interesat matës të AMA-s.

INTERPRETIMET

P1. Sa respektohen standardet e ruajtjes së privatësisë nga mediat audiovizive shqiptare, të parashikuara në Kodin e Transmetimit? (1 keq dhe 7 mirë)

a) Publikimi i të dhënave personale me autorizimin e vetë personit

Mesatarja e përgjithshme është **3.75**, një kuotë që supozon se të anketuarit mendojnë që ky standard i parashikuar në Kodin e Transmetimit, respektohet disi nga mediat audiovizive shqiptare.

Në pikëpamje numerike:

45

të anketuar mendojnë se publikimi i të dhënave personale me autorizimin e vetë personit respektohet pak nga mediat audiovizive;

66

të anketuar që ky standard respektohet disi;

61

mendojnë që respektohet mjaftueshëm, dhe;

8

të anketuar japin vlerësimin maksimal, pra që mediat audiovizive e respektojnë mirë këtë parim të Kodit të Transmetimit për ruajtjen e privatësisë.

b) Publikimi i autorizuar i ambienteve private

Mesatarja e përgjithshme është **3.86**, një kuotë pak më e lartë se pika a).

Të anketuarit mendojnë që edhe ky standard i ruajtjes së privatësisë respektohet disi nga mediat audiovizive shqiptare.

Nëse u referohemi shifrave:

44

të anketuar mendojnë se mediat audiovizive e respektojnë pak parimin për publikimin e autorizuar të ambienteve private;

60

të anketuar mendojnë se e respektojnë disi;

46

mendojnë që respektohet mjaftueshëm, dhe;

13

të anketuar mendojnë se ky standard respektohet shumë.

c) Regjistrimi i video-audio me dijeninë e personit që regjistrohet

Ka një mesatare pak më të lartë se pikat a) dhe b) që përfshin dy standarde të tjera të ruajtjes së privatësisë, gjegjësisht publikimi i të dhënave personale me autorizimin e vetë personit, si dhe publikimi i autorizuar i ambienteve private.

Mediat audiovizive vlerësohen më mirë kur bëhet fjalë për regjistrimin e video-audiove me dijeninë e personit që regjistrohet, me një mesatare prej **3.9**.

Sipas shifrave:

47

prej të anketuarve mendojnë se standardi i sipërcituar respektohet pak nga mediat audiovizive;

58

që e respektojnë disi;

47

që e respektojnë mjaftueshëm, dhe;

13

që e respektojnë shumë.

d) Privatësia mbi zgjedhjet personale intime

Duket se për këtë standard të ruajtjes së privatësisë të anketuarit kanë mendim jo të mirë për mediat audiovizive.

Me një mesatare më të ulët se të gjitha pyetjet e tjera, **3.53;**

63

të anketuar mendojnë që privatësia mbi zgjedhjet personale intime respektohet pak nga mediat audiovizive;

58

që respektohet disi;

46

që respektohet mjaftueshëm, dhe;

13

që respektohet mirë/shumë.

Sikurse vihet re, pjesa më e madhe e të anketuarve janë tek vlerësimi "pak" dhe "disi", çka është një vlerësim i ulët.

e) Respektimi i privatësisë ndaj të miturve.

Edhe për këtë standard të respektimit të privatësisë, të anketuarit japin vlerësim negativ, duke e renditur poshtë mesatares, por pak pikë më shumë se standardi d).

Me mesatare **3.64** (i katërti në tërësi) respektimi i privatësisë së fëmijëve ofron këtë panoramë, në bazë të përgjigjeve të dhëna nga të anketuarit:

61

prej të anketuarve mendojnë se ky standard respektohet pak nga mediat audiovizive;

53

mendojnë që respektohet disi;

49

që respektohet mjaftueshëm, dhe;

17

që respektohet shumë.

Në përmbyllje:

Nga 5 standardet e ruajtjes së privatësisë, të përfshira në pyetjen e parë të këtij anketimi, vlerësimi më negativ vjen për respektimin e privatësisë ndaj të miturve dhe privatësia mbi zgjedhjet personale intime.

P2. Sa konsideroni që mediat audiovizive janë në mbrojtje të interesit publik? (1 keq dhe 7 mirë)

Në përgjithësi, të anketuarit japin një vlerësim jo të mirë për këtë pyetje. Mesatarja **3.2** është shumë poshtë mesatares së përgjithshme, gjithsesi ajo ndryshon sipas zonave të anketimit, arsimimit dhe moshës së të anketuarve.

Vlerësimin më të ulët e japin të anketuarit në qendër **(2.83)**, ata me arsim fillor **(2.5)** dhe grupmosha 35 deri në 49 vjeç **(2.9)**.

Sa i përket shtrirjes së zonave të anketimit, renditja paraqitet si më poshtë:

Të anketuarit që banojnë në qendër vlerësojnë me **2.83 pikë** mediat audiovizive kur bëhet fjalë për mbrojtjen e interesit publik;

Të anketuarit nga zonat informale japin **3.33 pikë**, dhe;

Të anketuarit nga periferia **3.46 pikë**;

Sa i përket vlerësimin sipas shkallës së arsimit të të anketuarve, renditja paraqitet e tillë:

Të anketuarit me arsim pasuniversitar japin vlerësimin më të ulët, **2.43 pikë**;

Pasuar nga ata me arsim fillor me **2.5 pikë**;

Të anketuarit me arsim universitar e vlerësojnë me **3.06 pikë**;

Të anketuarit me arsim të mesëm, **3.15 pikë**

Të anketuarit me arsim 8-vjeçar japin vlerësimin më të lartë, me **3.9 pikë**.

Sipas grupmoshës së të anketuarve, kemi këtë tablo:

Të anketuarit nga mosha 12 deri në 17 vjeç mendojnë se mediat audiovizive janë disi në mbrojtje të interesit publik;

Të anketuarit nga mosha 18-34 vjeç mendojnë se mediat audiovizive pak e mbrojnë interesin publik; Po kështu mendojnë dhe të anketuarit nga 35-49 vjeç (që japin **2.9 pikë**) si dhe grupmosha mbi 50 vjeç (me **3.45 pikë**).

Sa i përket ndarjes në meshkuj dhe femra të të anketuarve, ka një diferencë mes tyre prej 4-5 pikë në vlerësimin që kanë për mbrojtjen e interesit publik nga media audiovizive. Gjithsesi, të dy vlerësimet janë nën mesataren e përgjithshme.

Meshkujt japin vlerësimin më të dobët, me **2.99 pikë**, ndërsa femrat **3.45 pikë**.

Në pikëpamje numerike:

Sipas zonës së banimit - Qendër

27 të anketuar mendojnë se mediat audiovizive e mbrojnë pak interesin publik;

21 mendojnë që e mbrojnë disi;

11 mendojnë që e mbrojnë mjaftueshëm, dhe;

1 i anketuar jep vlerësim maksimal.

Sipas zonës së banimit - Periferi

19 të anketuar mendojnë se mediat audiovizive e mbrojnë pak interesin publik;

23 mendojnë që e mbrojnë disi;

15 mendojnë që e mbrojnë mjaftueshëm, dhe;

3 të anketuar vlerësojnë maksimalisht mediat audiovizive për mbrojtjen e interesit publik.

Sipas zonës së banimit - Informale

22

të anketuar mendojnë se mediat audiovizive e mbrojnë pak interesin publik;

22

mendojnë që e mbrojnë disi;

14

mendojnë që e mbrojnë mjaftueshëm, dhe;

3

të anketuar japin vlerësim maksimal.

Vihet re diferenca midis perceptimit që kanë të anketuarit që banojnë në qendër ose rreth saj **(2.83 pikë)** me dy kategoritë e tjera, banorët në periferi dhe zonat informale, të cilët janë më pranë mesatares së përgjithshme **(3.33)** dhe **3.46 pikë**), kur bëhet fjalë për mbrojtjen e interesit publik nga mediat audiovizive.

Në pikëpamje numerike:

Sipas nivelit të arsimit - Fillor

4

të anketuar mendojnë se mediat audiovizive e mbrojnë pak interesin publik;

1

mendon që e mbrojnë disi;

0

i anketuar nuk e vlerëson me mjaftueshëm, dhe;

1

i anketuar jep vlerësim maksimal.

Sipas nivelit të arsimit - Tetëvjeçar

8

të anketuar mendojnë se mediat audiovizive e mbrojnë pak interesin publik;

17

mendojnë që e mbrojnë disi;

13

të anketuar e vlerësojnë mjaftueshëm, dhe;

1

i anketuar jep vlerësim maksimal.

Sipas nivelit të arsimit - I mesëm

8

të anketuar mendojnë se mediat audiovizive e mbrojnë pak interesin publik;

17

mendojnë që e mbrojnë disi;

13

të anketuar e vlerësojnë mjaftueshëm, dhe;

1

i anketuar jep vlerësim maksimal.

Sipas nivelit të arsimit - Universitar

14

të anketuar mendojnë se mediat audiovizive e mbrojnë pak interesin publik;

11

të anketuar mendojnë që e mbrojnë disi;

9

e vlerësojnë mjaftueshëm, dhe;

0

asnjë nuk jep vlerësim maksimal.

Sipas nivelit të arsimit - Pasuniversitar

8

të anketuar mendojnë se mediat audiovizive e mbrojnë pak interesin publik;

5

të anketuar mendojnë që e mbrojnë disi;

0

asnjë nuk jep vlerësimin mjaftueshëm, dhe;

1

i anketuar jep vlerësim maksimal.

Dukshëm ka një diferencë në vlerësimin që të anketuarit japin për këtë pyetje. Sipas nivelit të arsimit të tyre ka dhe perceptime të ndryshme. Kështu, ata që japin vlerësimin më të dobët janë të anketuarit me arsim pasuniversitar, ndërsa vlerësimin maksimal e japin ata me shkollë të mesme.

Në pikëpamje numerike:

Sipas grupmoshës 12-17 vjeç

3

të anketuar mendojnë se mediat audiovizive e mbrojnë pak interesin publik;

14

të anketuar mendojnë që e mbrojnë disi;

10

japin vlerësimin mjaftueshëm, dhe;

0

asnjë i anketuar nuk jep vlerësim maksimal.

Sipas grupmoshës 18-34 vjeç

21

të anketuar vlerësojnë që mediat audiovizive e mbrojnë pak interesin publik;

17

të anketuar mendojnë që e mbrojnë disi;

12

mendojnë që e mbrojnë mjaftueshëm, dhe;

1

i anketuar mendon që mediat audiovizive e mbrojnë shumë interesin publik.

Sipas grupmoshës 35-49 vjeç

21

të anketuar mendojnë që mediat audiovizive e mbrojnë pak interesin publik;

19

të anketuar mendojnë që e mbrojnë disi;

10

të anketuar mendojnë se mediat audiovizive e mbrojnë pak interesin publik;

2

të anketuar japin vlerësim maksimal.

Sipas grupmoshës mbi 50 vjeç

14

të anketuar mendojnë se mediat audiovizive e mbrojnë pak interesin publik;

15

të anketuar mendojnë që e mbrojnë disi;

8

mendojnë që e mbrojnë mjaftueshëm, dhe;

3

të anketuar mendojnë që mediat audiovizive e mbrojnë shumë interesin publik.

Përgjigjet sipas gjinisë

Meshkujt janë thujse në të njëjtën mesatare të përgjithshme, **2,99**. Ndërsa femrat e anketuara janë disa pikë mbi mesataren e përgjithshme – **3.45**.

Me gjuhën e shifrave, **44 meshkuj** mendojnë se mediat audiovizive pak e mbrojnë interesin publik, përkundër **25 femrave** që japin të njëjtën vlerësim.

Nuk ka asnjë ndryshim kur bëhet fjalë për vlerësimin maksimal, ata ndahen **10 me 10** që mendojnë se interesi publik mbrohet shumë nga mediat audiovizive. Pra, perceptimi në këtë rast është identik.

P3. Sa i respektojnë mediat audiovizive vlerat e mëposhtme me interes publik, duke i vlerësuar me notë 1-7 (1 keq dhe 7 mirë)

A) Diversiteti kulturor

Mesatarja e përgjithshme është **4.0**, që do të thotë se kjo vlerë me interes publik respektohet disi nga mediat audiovizive

Me gjuhën e shifrave:

39

të anketuar mendojnë se mediat audiovizive e respektojnë pak diversitetin kulturor si vlerë me publikimi i të dhënave personale me autorizimin e vetë personit respektohet pak nga mediat audiovizive;

71

të anketuar mendojnë që kjo vlerë respektohet disi;

51

mendojnë që respektohet mjaftueshëm, dhe;

19

19 të anketuar mendojnë që respektohet shumë.

B) E drejta për informacion

Mesatarja e përgjithshme është **4.25**, me një përmirësim të dukshëm me diversitetin kulturor. Siç duket, të anketuarit mendojnë se mediat audiovizive e respektojnë më mirë të drejtën për informacion, si një nga vlerat e interesit publik.

Me gjuhën e shifrave:

25

të anketuar mendojnë se mediat audiovizive e respektojnë pak të drejtën për informacion;

80

të anketuar mendojnë që kjo vlerë respektohet disi;

55

mendojnë që respektohet mjaftueshëm, dhe;

20

të anketuar mendojnë që respektohet shumë.

C) Pluralizmi (i ideve) në media

Ka një mesatare të përgjithshme **(4.2)** thuajse si e drejta për informacion, e paraqitur në pikën b), që ishte **4.25**.

Sipas shifrave:

33

të anketuar mendojnë se mediat audiovizive e respektojnë pluralizmin (e ideve);

67

të anketuar mendojnë që kjo vlerë respektohet disi;

54

mendojnë që respektohet mjaftueshëm, dhe;

26

të anketuar mendojnë që respektohet shumë.

21 Mbrojtja e të miturve

Mesatarja e përgjithshme **(4.1)** ka një rënie në raport me dy vlerat pararendëse, duke supozuar se mediat audiovizive e respektojnë disi "mbrojtjen e të miturve".

Nëse u referohemi shifrave:

43

të anketuar mendojnë se mbrojtja e të miturve si vlerë e interesit publik respektohet pak nga mediat audiovizive;

61

të anketuar mendojnë që kjo vlerë respektohet disi;

52

mendojnë që respektohet mjaftueshëm, dhe;

26

të anketuar mendojnë që respektohet shumë.

22 Mbrojtja e konsumatorit

Mesatarja e përgjithshme **(3.67)** ka një rënie të dukshme, duke supozuar se të anketuarit kanë dhënë vlerësim jo të mirë për mediat audiovizive përballë mbrojtjes së konsumatorit.

Edhe shifrat e ilustrojnë këtë perceptim.

46

të anketuar mendojnë se mbrojtja e të konsumatorit si vlerë e interesit publik respektohet pak nga mediat audiovizive;

76

të anketuar mendojnë që kjo vlerë respektohet disi;

47

mendojnë që respektohet mjaftueshëm, dhe;

11

të anketuar mendojnë që respektohet shumë.

23 Mbrojtja e publikut nga keqorientimi

Edhe për këtë vlerë të interesit publik, mesatarja e përgjithshme **(3.56)** vjen në rënie.

Dhe sipas shifrave, tabloja është e tillë:

56

të anketuar mendojnë se mbrojtja e publikut nga keqorientimi si vlerë e interesit publik respektohet pak nga mediat audiovizive;

70

të anketuar mendojnë që kjo vlerë respektohet disi;

44

mendojnë që respektohet mjaftueshëm, dhe;

10

të anketuar mendojnë që respektohet shumë.

Si konkluzion, mund të themi se:

Raporti i mediave audiovizive me vlera të interesit publik nuk është i mirë. Nëse për vlera si diversiteti kulturor apo e drejta për informacion ka një perceptim deri diku të pranueshëm, mbrojtja e konsumatorit apo mbrojtja e publikut nga keqorientimi qëndrojnë nën mesataren e përgjithshme, duke sugjeruar përmirësimin e këtij raporti.

P4. Sa në respekt të standardeve të vërtetësisë dhe të saktësisë e konsideroni informacionin në media? Jepni një vlerësim nga 1-7. (1 keq dhe 7 mirë)

Sipas mesatares së përgjithshme **(3.56)** të anketuarit mendojnë se informacioni në mediat audiovizive i respekton disi standardet e vërtetësisë dhe të saktësisë.

Ndarë sipas gjinisë, meshkujt kanë vlerësim më të ulët **(3.43)** në krahasim me femrat që japin notën **3.65.**

Ndërsa sipas nivelit të arsimimit, kjo mesatare përkeqësohet nga përgjigjet e të anketuarve me arsim pasuniversitar **(3.14)**, një notë shumë e ulët kjo, ndjekur nga të anketuarit me arsim universitar **(3.2)**, ata me arsim fillor **(3.33)**, ata me arsim të mesëm me **3.6 pikë** dhe në fund ata me tetëvjeçare që japin notën **3.87.**

Sikurse vërehet, të arsimuarit në një shkallë më të lartë japin vlerësim të dobët, duke sugjeruar se informacioni në mediat audiovizive i respekton pak ose disi standardet e vërtetësisë dhe të saktësisë.

Sipas grupmoshave, thajse kemi të njëjtën panoramë, me ndryshimin e vetëm që të anketuarit midis moshës 12-17 vjeç japin notën më të mirë **(4.33)**

Më tej, grupmoshat 18-24 vjeç; 35-49 vjeç dhe ata mbi 50 vjeç japin përkatësisht notat **3.43; 3.53 dhe 3.25.**

Panorama ilustruhet dhe nga pikëpamja numerike, ku pjesa dërrmuese e të anketuarve (qoftë sipas nivelit të arsimimit që kanë, qoftë dhe nga mosha e tyre) mendojnë se informacioni në mediat audiovizive i respekton disi standardet e vërtetësisë dhe të saktësisë.

P5. Sa objektiv dhe i pavarur është informacioni që marrim nga mediat audioviziv? Nga 1 deri në 7, ku 1 është vlera më e ulët dhe 7 vlera më e lartë.

Me një mesatare të përgjithshme prej **2.67 pikë**, të anketuarit sugjerojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është pak i pavarur dhe objektiv.

Kjo mesatare përkeqësohet dhe më tej, nga vlerësimi që japin të anketuarit sipas zonave të banimit, gjinisë, nivelit të arsimimit dhe moshës.

Vlerësimin më të ulët e japin të anketuarit me arsim pasuniversitar **(1.57)** dhe më të lartë **(3.37)** të anketuarit e moshës 12-17 vjeç. Pjesa tjetër japin vlerësime midis notës **2 dhe 4.**

Nga pikëpamja numerike:

Sipas zonës së banimit - Qendër

34

të anketuar mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është pak objektiv dhe i pavarur;

14

të anketuar mendojnë që është disi objektiv dhe i pavarur;

9

mendojnë që është mjaftueshëm i tillë, dhe;

5

të anketuar mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është shumë objektiv dhe i pavarur.

Sipas zonës së banimit - Periferi

35

të anketuar mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është pak objektiv dhe i pavarur;

17

të anketuar mendojnë që është disi objektiv dhe i pavarur;

7

mendojnë që është mjaftueshëm i tillë, dhe;

1

i anketuar mendon se informacioni është shumë objektiv dhe i pavarur.

Sipas zonës së banimit - Informale

30

të anketuar mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është pak objektiv dhe i pavarur;

20

të anketuar mendojnë që është disi objektiv dhe i pavarur;

9

mendojnë që informacioni është mjaftueshëm i tillë, dhe;

1

i anketuar mendon se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është shumë objektiv dhe i pavarur.

Duket që nuk ka ndonjë ndryshim të dukshëm në perceptimin që kanë të anketuarit për këtë pyetje, pavarësisht zonës së tyre të banimit.

Ndryshimi është tek perceptimi që kanë femrat dhe meshkujt. Nëse femrat japin notën **3.12**, meshkujt japin notë shumë më të ulët, **2.25**.

Numerikisht:

Femrat:

38

të anketuara mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është pak objektiv dhe i pavarur;

28

të anketuara mendojnë që është disi objektiv dhe i pavarur;

16

që është mjaftueshëm, dhe;

4

të anketuara mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është shumë objektiv dhe i pavarur.

Numerikisht:

Meshkujt:

61

të anketuar mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është pak objektiv dhe i pavarur;

23

të anketuar mendojnë që është disi objektiv dhe i pavarur;

9

që është mjaftueshëm, dhe;

1

mendon se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është shumë objektiv dhe i pavarur.

Në pikëpamje numerike:

Sipas nivelit të arsimit - Fillor

4

të anketuar mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është pak objektiv dhe i pavarur;

1

i anketuar mendon që është disi objektiv dhe i pavarur;

1

i anketuar mendon që është mjaftueshëm, dhe;

0

asnjë i anketuar nuk jep vlerësim maksimal.

Sipas nivelit të arsimit - Tetëvjeçar

22

të anketuar mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është pak objektiv dhe i pavarur;

12

të anketuar mendojnë që është disi objektiv dhe i pavarur;

3

të anketuar mendojnë që informacioni është mjaftueshëm i tillë, dhe;

2

mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është shumë objektiv dhe i pavarur.

Sipas nivelit të arsimit - I mesëm

8

të anketuar mendojnë se mediat audiovizive e mbrojnë pak interesin publik;

17

mendojnë që e mbrojnë disi;

13

të anketuar e vlerësojnë mjaftueshëm, dhe;

2

mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është shumë objektiv dhe i pavarur.

Sipas nivelit të arsimit - Universitar

20

të anketuar mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është pak objektiv dhe i pavarur;

9

të anketuar mendojnë që është disi objektiv dhe i pavarur;

4

të anketuar mendojnë që informacioni është mjaftueshëm i tillë, dhe;

1

i anketuar mendon se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është shumë objektiv dhe i pavarur.

Sipas nivelit të arsimit - Pasuniversitar

11

të anketuar mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është pak objektiv dhe i pavarur;

2

të anketuar mendojnë që është disi objektiv dhe i pavarur;

1

i anketuar vlerëson që informacioni është mjaftueshëm i tillë, dhe;

0

asnjë i anketuar nuk jep vlerësim maksimal.

Vihet re diferenca e lartë që të anketuarit me arsim pasuniversitar kanë me nivelet e tjera të arsimit. Të parët janë notën më të dobët për mediat audiovizive kur përballen me pyetjen nëse informacioni që marrim prej tyre është objektiv dhe i pavarur.

Në pikëpamje numerike:

Sipas grupmoshës 12-17 vjeç

10

të anketuar mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është pak objektiv dhe i pavarur;

11

të anketuar mendojnë që është disi objektiv dhe i pavarur;

4

të anketuar mendojnë që informacioni është mjaftueshëm i tillë, dhe;

2

të anketuar japin vlerësim maksimal.

Sipas grupmoshës 18-34 vjeç

25

të anketuar mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është pak objektiv dhe i pavarur;

14

të anketuar mendojnë që informacioni është disi objektiv dhe i pavarur;

8

të anketuar mendojnë që informacioni është mjaftueshëm i tillë, dhe;

2

të anketuar japin vlerësim maksimal.

Sipas grupmoshës 35-49 vjeç

40

të anketuar mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është pak objektiv dhe i pavarur;

16

të anketuar mendojnë që është disi objektiv dhe i pavarur;

6

të anketuar mendojnë që informacioni është mjaftueshëm i tillë, dhe;

0

asnjë i anketuar nuk jep vlerësim maksimal.

Sipas grupmoshës mbi 50 vjeç

24

të anketuar mendojnë se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është pak objektiv dhe i pavarur;

10

të anketuar mendojnë që është disi objektiv dhe i pavarur;

5

të anketuar mendojnë që informacioni është mjaftueshëm i tillë, dhe;

1

i anketuar mendon se informacioni që marrim nga mediat audiovizive është shumë objektiv dhe i pavarur.

Ndryshe nga të anketuarit sipas arsimit, të anketuarit sipas grupmoshave nuk kanë diferenca të dukshme sa i përket perceptimit të tyre mbi informacionin që marrim nga mediat audiovizive, nëse ai është objektiv dhe i pavarur. Me përjashtim të grupmoshës 12-17 vjeç, të gjithë të tjerët thuajse kanë të njëjtin mendim.

P6. Informimi masiv, në vlerësimin tuaj, është më tepër në shërbim të publikut apo u shërben interesave të ngushta të mediave? (Vetëm 1 përgjigje)

Ka një përqindje të konsiderueshme, 74%, e të anketuarve, të cilët mendojnë se informimi masiv është në shërbim të interesave të medias. 16% mendojnë se informimi masiv është pjesërisht në shërbim të publikut, dhe 11% e të anketuarve nuk shprehin asnjë opinion.

Të njëjtin shqetësim shprehin të anketuarit, edhe sipas zonës së banimit, gjinisë, nivelit të arsimit dhe moshës së tyre.

Kështu, të anketuarit banorë të Qendrës, Periferisë dhe Zonave Informale, mendojnë se informimi masiv është në shërbim të interesave të medias përkatësisht 75%, 77% dhe 70%.

Që informimi masiv është pjesërisht në shërbim të publikut e mendojnë 8% e të anketuarve banorë në Qendër, 20% e të anketuarve nga Periferia dhe 18% e atyre nga Zonat Informale.

Ndërkaq, nuk kanë asnjë opinion 17% e të anketuarve nga Qendra, 3% e të anketuarve nga Periferia dhe 12% e të anketuarve nga Zonat Informale.

E shprehur në shifra, të anketuarit sipas gjinisë, ofrojnë këtë tablo:

12 femra të anketuara (ose 14%) mendojnë se informimi masiv është pjesërisht në shërbim të publikut, 65 të tjerë (ose 76%) mendojnë që është në shërbim të interesave të medias dhe 9 të anketuara (ose 10%) nuk kanë asnjë opinion.

Pra, pjesa dërrmuese e tyre japin notën më të dobët për mediat audiovizive sa i përket informimit masiv dhe interesave që media mbron.

Me pak diferencë, e njëjta tablo paraqitet edhe për gjininë tjetër.

17 meshkuj të anketuar (ose 18%) mendojnë se informimi masiv është pjesërisht në shërbim të publikut, ndërsa 67 (ose 71%) mendojnë që është në shërbim të interesave të medias. 10 të anketuar ose (11%) nuk shprehin asnjë opinion.

Sipas nivelit të arsimit:

Që informimi masiv është në shërbim të interesave të ngushta të medias e mendojnë 67% e të anketuarve me arsim fillor; 64% e atyre me arsim tetëvjeçar; 75% e të anketuarve me arsim të mesëm; 74% e atyre me arsim universitar dhe 100% e të anketuarve me arsim pasuniversitar.

Që informimi masiv është pjesërisht në shërbim të publikut e mendojnë 33% e të anketuarve me arsim fillor; 23% e atyre me arsim tetëvjeçar; 15% e të anketuarve me arsim të mesëm; 12% e atyre me arsim universitar dhe asnjë nga të anketuarit me arsim pasuniversitar.

Sipas grupmoshave:

Informimi masiv është në shërbim të interesave të ngushta të medias... këtë e mendojnë 63% e të anketuarve të moshës 12-17 vjeç; 76% e atyre që i përkasin grupmoshës 18-34 vjeç; 74% e grupmoshës 35-49 vjeç; si dhe 78% e moshës mbi 50 vjeç.

Informimi masiv është pjesërisht në shërbim të publikut... këtë e mendojnë 22% e të anketuarve të moshës 12-17 vjeç; 12% e atyre që i përkasin grupmoshës 18-34 vjeç; 16% e grupmoshës 35-49 vjeç; si dhe 15% e moshës mbi 50 vjeç.

Shifrat e atyre që nuk shprehin asnjë opinion, thuajse, në të gjitha rastet e mësipërme janë të papërfillshme.

Si konkluzion mund të thuhet se raporti i medias audiovizive me informimin masiv, pra se kujt i shërben në këtë rast – publikut apo vetes - ka marrë vlerësimin më negativ nga pjesa dërrmuese e të anketuarve, pas asnjë dallim.

P7. A janë sipas jush mediat të ndjeshme ndaj vërejtjeve dhe kritikave të publikut? Jepni një vlerësim nga 1-7 (1 keq dhe 7 mirë)

Mesatarja e përgjithshme është **3.05**, duke pasur vlerësim disi nga publiku për ndjeshmërinë e mediave ndaj vërejtjeve dhe kritikave të publikut.

73

qytetarëve e kanë vlerësuar me notën me të ulët 1 dhe 2.

65

prej tyre e kanë vlerësuar si disi të ndjeshme, duke e vlerësuar me notën 3 dhe 4.

38

prej qytetarëve mendojnë se është mjaftueshme e ndjeshme, duke dhënë pëlqimin për notat 5 dhe 6

4

prej qytetarëve e vlerësojnë si shumë të ndjeshme median për vërejtjet dhe kritikave të tyre.

Përgjigja sipas zonës së banimit- Qendër

Mesatarja e përgjithshme për qytetarët që banojnë në qendër është **2.78**.

27

prej qytetarëve janë shprehur se nuk ka asnjë ndjeshmëri, duke e vlerësuar me notën 1 dhe 2.

23

prej tyre e kanë vlerësuar disi duke dhënë vlerësimin me 3 dhe 4

10

prej tyre mendojnë se është mjaftueshëm

1

mendon se media është shumë e ndjeshme.

Përgjigja sipas zonës së banimit- Periferi

Mesatarja e përgjithshme e vlerësimit nga qytetarët që jetojnë në periferi është **2.93** me një vlerësim me të lartë se qytetarët që jetojnë në qendër.

29

qytetarë kanë dhënë notën 1 dhe 2

15

kanë dhënë notën disi

15

prej tyre mendojnë se është mjaftueshëm

1

mendon se media është shumë e ndjeshme.

Sipas zonës së banimit - Informale

Mesatarja e përgjithshme e vlerësimit nga qytetarët që jetojnë në zonë informale është **3.38**, duke qene më e lartë se mesatarja e qytetarëve në vendbanime të tjera.

18

prej tyre kanë dhënë notën 1 dhe 2 duke e vlerësuar si pak të ndjeshme median.

27

e kanë vlerësuar disi

13

mjaftueshëm

2

si shumë të ndjeshme.

Si përfundim, vihet re se sa më pranë zonave urbane, qytetarët vlerësojnë më pak ndjeshmërinë e medias ndaj sugjerimeve dhe kritikave të tyre.

Përgjigja sipas gjinisë- Meshkujt

Mesatarja e të pyeturve meshkujt ndaj pyetjeve së ndjeshmërisë së mediave ndaj kritikave dhe sugjerimeve të publikut është **2.9**.

45

prej tyre janë vlerësuar me notën 1 dhe 2, pra me vlerësimin pak.

28

e kanë vlerësuar me vlerësimin disi, me notën 3 dhe 4

20

e kanë vlerësuar mjaftueshëm me notën 5 dhe 6

1

mendon se është shumë e ndjeshme.

Përgjigja sipas gjinisë- Femra

Mesatarja e të pyeturve femra ndaj të njëjtës pyetje është **3.16**, duke pasur një vlerësim pak më të lartë se meshkujt për ndjeshmërinë e mediave ndaj vërejtjeve dhe kritikave të publikut.

29

prej tyre kanë dhënë vlerësim të ulët, me notën 1 dhe 2.

37

mendojnë se media është disi e ndjeshme

17

e mendojnë si të mjaftueshëm

3

prej tyre japin vlerësim maksimal me notën 7.

Përgjigja sipas nivelit të arsimit

Sipas nivelit të arsimit - Fillor

Mesatarja e përgjithshme e të pyeturve me arsim fillor është **2.5** ndërsa duhet theksuar se vetëm **6** qytetarë gjithsej nga e gjithë kampioni është me arsim fillor.

Tetëvjeçar

Mesatarja e përgjithshme e të pyeturve me arsim tetëvjeçar është më e larta, me **3.43**. Në tërësi, **13** qytetarë mendojnë se mediat janë pak të ndjeshme, **14** mendojnë disi dhe **12** mjaftueshëm.

I mesëm

Mesatarja e përgjithshme e të pyeturve me arsim të mesëm është **3.03**. Në total, **32** e të pyeturve me këtë arsim mendojnë se mediat janë pak të ndjeshme ndaj kritikave të publikut, **38** prej tyre e vlerësojnë disi të ndjeshme ndërsa **14** të mjaftueshëm. Vetëm **3** prej tyre kanë dhënë vlerësimin më të lartë me notën 7.

Universitar

Mesatarja e përgjithshme e të pyeturve me arsim universitar është **2.94**, **17** prej tyre mendojnë se është pak e ndjeshme, **7** mendojnë disi dhe **9** mjaftueshëm. **Një** prej tyre e ka vlerësuar maksimalisht.

Pasuniversitar

Mesatarja e përgjithshme e të pyeturve me arsim pasuniversitar është **2.21**, duke qenë më e ulëta, **9** prej të pyeturve kanë vlerësuar me notat 1 dhe 2. Vetëm **4** kanë dhënë notën 3, pra disi dhe me votën 6 e ka dhënë vetëm **një qytetar** me arsim pasuniversitar.

Si përfundim, ka një lidhje të drejtpërdrejtë me perceptimit për ndjeshmërinë e medias ndaj vërejtjeve dhe kritikave të publikut dhe arsimimit. Sa më i ulët niveli arsimor, aq më i lartë është besimi tek media dhe sa më i lartë niveli arsimor, aq më i ulët është ky besim.

P8. Nga 1-7, sa respektohet privatësia e fëmijëve në ruajtjen e identitetit të fëmijëve në ekran?

Mesatarja e përgjithshme e të pyeturve është **3.95**. Perceptimi i të anketuarve është se privatësia dhe ruajtja e identitetit të fëmijëve në ekranet televizive respektohet disi.

56

e qytetarëve në total të pyetur japin vlerësimin minimal me notat 1 dhe 2;

46

japin vlerësimin me 3 dhe 4, pra disi respektohet privatësia;

44

e qytetarëve e vlerësojnë mjaftueshëm;

23

prej tyre japin notën maksimale për respektimin e privatësisë dhe identitetit të fëmijëve në ekran;

P9. I konsideroni korrekte dhe të përshtatura sipas moshës format e intervistimit të fëmijëve në mediat audiovizive? (1 shënon fare jokorrekte dhe 7 krejtësisht korrekte)

Mesatarja e përgjithshme e të pyeturve është

3.6.

64

japin vlerësimin 1 dhe 2 duke e parë intervistimin e fëmijëve më pak korrekt;

53

japin vlerësimin disi, pra me notën 3 dhe 4;

51

japin vlerësimin mjaftueshëm, pra me notën 5 dhe 4;

12

prej tyre e vlerësojnë si krejtësisht korrekte intervistimin e fëmijëve në mediat audiovizive;

P10. Tek reklamat që kanë për subjekt fëmijët, konsideroni më problematike:

- A** Produktet që reklamohen
 - B** Roli i fëmijëve në reklamë
 - C** Paaftësinë e fëmijëve për të kuptuar qëllimin e reklamës
 - D** Fakti që reklamat janë me natyrë tregtare
-

20

prej qytetarëve të pyetur, ose **11 %** e tyre që shohin si problematike produktet në reklamat me subjekt fëmijët.

37

prej tyre ose **21 %** e të anketuarve duke parë si më problematike vetë rolin e fëmijëve në reklama.

55

qytetarë ose **31 %** e tyre duke parë më problematike paaftësinë e fëmijëve për të kuptuar qëllimin e reklamave.

68

prej qytetarëve ose **38 %** e qytetarëve, më shumë se 3 alternativat e tjera, duke parë si problematike natyrën tregtare të reklamave.

P11. Jepni një vlerësim nga 1 deri në 7 se sa respektohen këto rregulla nga programacioni i mediave audiovizive:

Integriteti fizik dhe mendor i të miturve

Mesatarja e kësaj përgjigje është 3.8, duke pasur një vlerësim pothuaj neutral.

39

prej qytetarëve kanë dhënë vlerësim me notat 1 dhe 2

82

prej tyre me notat 3 dhe 4

47

me notat 5 dhe 6

12

kanë dhënë vlerësim maksimal me notën 7

Fashat e orareve sipas programeve të veçanta

Mesatarja e kësaj përgjigjeje është 3.95 me një vlerësim sërish neutral.

35

qytetarë që kanë dhënë vlerësim në ulët me 1 ose 2

51

kanë dhënë vlerësim 3 ose 4

71

me vlerësim mjaftueshëm me 5 dhe 6

11

prej tyre kanë dhënë vlerësim maksimal

Sinjalet paralajmëruese për programe

Mesatarja e përgjithshme për këtë përgjigje është 4.36, duke qenë një vlerësim mjaftueshëm.

35

qytetarë e shohin si problematik shenjat paralajmëruese duke dhënë vlerësim negativ me 1 ose 2

56

mendojnë se disi është problematike

63

mendojnë se respektohen mjaftueshëm

26

mendojnë se aty respektohen tërësisht

Kujdesi për të mos krijuar varësi nga programe të caktuara

Kjo përgjigje ka një mesatare 3.3, duke u vlerësuar si një perceptim neutral nga qytetarët

55

prej tyre e shohin si problem që nuk ka kujdes ndaj programeve të veçanta që mund të krijojnë varësi, duke dhënë vlerësim me 1 ose 2

71

prej tyre mendojnë se disi ka kujdes

39

besojnë se kujdesi është i mjaftueshëm

5

prej tyre besojnë se ka kujdes sa duhet

Kujdesi ndaj komuniteteve me aftësi të kufizuar

Mesatarja e kësaj përgjigje është 3.77, duke treguar për një perceptim qytetar që nuk ka kujdes mjaftueshëm ndaj komuniteteve me aftësi të kufizuar

46 besojnë se nuk ka kujdes me vlerësimin 1 ose 2

70 qytetarë besojnë se ka disa kujdes

51 Mjaftueshëm kujdes ndaj këtyre komuniteteve besojnë se ka

13 prej tyre mendojnë se kujdesi është i plotë

Nivelit të përshtatshëm edukues për fëmijët

Mesatarja e kësaj përgjigje është 3.35.

69 qytetarë që kanë dhënë vlerësim në ulët me 1 ose 2

63 kanë dhënë vlerësim 3 ose 4

38 me vlerësim mjaftueshëm me 5 dhe 6

11 shumë edukues

Etika në gjuhën e folur dhe të shkruar

Mesatarja e kësaj përgjigje është 3.4, pothuaj neutrale në perceptimin e qytetarëve.

64 qytetarë japin vlerësim të ulët me 1 ose 2 pikë

68 e vlerësojnë që etika është disi problematike

39 qytetarë besojnë se etika në gjuhën e folur e të shkruar është mjaftueshëm korrekte

9 prej tyre e vlerësojnë si pa asnjë problem

Kujdesi për të mos prodhuar paragjykime

Mesatarja e kësaj përgjigjeje është 3.44, pothuaj neutrale.

63 qytetarë besojnë nuk ka kujdes në median audiovizive për të mos prodhuar paragjykime

67 besojnë se kjo është disi problem

44 e shohin mjaftueshëm me kujdes

5 prej tyre besojnë se ka kujdes nga mediat për të mos prodhuar paragjykime

Kujdesi për kontrollin prindëror

Mesatarja në këtë rast është 3.5, një vlerësim neutral i perceptimit nga publiku.

62

qytetarë besojnë se nuk ka kujdes për kontrollin prindëror nga ana e mediave, duke dhënë vlerësim me notën 1 ose 2

63

qytetarë besojnë se ka disi kontroll

43

qytetarë besojnë se ka mjaftueshëm kontroll

12

qytetarë besojnë se ka mjaftueshëm kontroll prindëror në mediat shqiptare

P12. Sa mbulohen nga mediat audiovizive problematikat e njerëzve me aftësi të kufizuar?

Vetëm **7%** e qytetarëve të pyetur, ose 13 prej tyre, besojnë se media mbulon tërësisht problematikat e njerëzve me aftësi të kufizuar. 112 qytetarë ose pjesa dërmuese e të pyeturve në **62%** besojnë se këto problematika mbulojnë vetëm disi. **21%** e qytetarëve ose **37%** besojnë se nuk mbulojnë aspak këto problematika, ndërsa 18 persona shprehen se nuk kanë informacion.



Në tërësi, pjesa dërmuese e qytetarëve vlerësojnë se mediat audiovizive nuk mbulojnë ose mbulojnë vetëm disi problematikat e qytetarëve me aftësi të kufizuar.

P13. Jepni një vlerësim nga 1 në 7 se sa respektohen këto normativa ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara përgjatë transmetimeve mediatike audiovizive:

Trajtim të drejtë dhe objektiv

Mesatarja e kësaj përgjigjeje është 3.7.

43

qytetarë besojnë se nuk ka një trajtim të drejtë dhe objektiv në media për njerëzit me aftësi të kufizuar

81

qytetarë besojnë disa objektiv dhe të drejtë duke dhënë vlerësimin me 3 ose 4

46

qytetarë besojnë se trajtimi është mjaftueshëm i drejtë dhe objektiv

10

qytetarë mendojnë se trajtimi është i drejtë dhe objektiv

Kujdesi për të mos krijuar paragjykime

Mesatarja është 3.79.

38

qytetarë besojnë nuk ka kujdes nga ana e medias për të mos krijuar paragjykime

87

qytetarë besojnë se ka disa kujdes, duke dhënë vlerësimin 3 ose 4

35

qytetarë besojnë se ka një kujdes të mjaftueshëm

20

qytetarë të tjerë besojnë se media është e kujdesshme për të mos krijuar paragjykime

Promovim i imazhit pozitiv të tyre

Mesatarja e kësaj përgjigjeje është 4.28, duke qenë një perceptim se media përgjithësisht promovon imazh pozitiv ndaj qytetarëve me aftësi të kufizuar.

28

qytetarë besojnë se media nuk promovon imazh pozitiv

66

besojnë se ka disa promovim

67

qytetarë besojnë se media promovon mjaftueshëm një imazh pozitiv

19

të tjerë besojnë se media promovon sa duhet një imazh pozitiv ndaj njerëzve në nevojë

Mostregtarizim të imazhit të tyre

Mesatarja e kësaj përgjigjeje është 3.38.

65

qytetarë japin vlerësim me notat 1 ose 2, duke besuar se imazhin i tyre komercializohet

63

qytetarë besojnë se vetëm disa është ky problem

41

besojnë se media tregon kujdes të mjaftueshëm për të mos tregtuar imazhin e njerëzve me aftësi të kufizuara

11

qytetarë besojnë se media nuk e komercializon imazhin e tyre

P14. Njihni ndonjë emision të prodhuar në vendet evropiane që të jetë transmetuar në mediat shqiptare?

ALTERNATIVAT

A

Po

B

Jo

C

Nuk e di

Sipas të dhënave, 52 qytetarë shprehen se po ose **29 %**, 84 shprehen jo ose **47%**, ndërsa 44 prej tyre ose **24 %** shprehen nuk e di.

Nëse **"Po"**, citoni titullin e emisionit dhe televizionin ku e keni hasur

A EMISIONI

EUROVISION	24
BIG BROTHER	4
OSCAR	4
YVSF	3
FORMULA 1	2
CHAMPIONS LEAGUE	2

Të tjerat janë përmendur 1 herë si: Golden Globe, MTV, X Factor, E Diela Shqiptare, Zonë e Lirë, Fiks Fare, Lojërat Olimpikë, Megi dhe Bianka, Amici, Moto GP, Music Awards.

B TELEVISIONI

TVSH	24
Top Channel	15
Klan	4
Vizion +	3
Canale 5	1

Të tjerat janë përmendur 1 herë si: Golden Globe, MTV, X Factor, E Diela Shqiptare, Zonë e Lirë, Fiks Fare, Lojërat Olimpikë, Megi dhe Bianka, Amici, Moto GP, Music Awards.

P15. Sa të pranishme e ndjeni kulturën evropiane në mediat shqiptare? (nga 1 deri në 7)

Mesatarja e përgjithshme e kësaj përgjigjeje është 3.78.

42

prej qytetarëve kanë vlerësuar me notat 1 dhe 2, duke mos e ndjerë fare të pranishëm kulturën evropiane në mediat shqiptare

83

prej tyre shprehen disi

37

e shohin si të mjaftueshëm

18

qytetarë besojnë se e ndjejnë mëse të pranishme në median shqiptare

Përgjigja sipas zonës së banimit- Qendër

Mesatarja e përgjithshme e atyre që jetojnë në qendër është **4.08**

11 vlerësojnë me notat 1 dhe 2, **29** me notat 3 dhe 4.

11 me notat 5 dhe 6 dhe **9** prej tyre me notën maksimale.

Periferi

Mesatarja e përgjithshme e atyre që jetojnë në periferi është 3.72

14

vlerësojnë me notat 1 dhe 2

26

me disi ose 3 dhe 4

15

mendojnë mjaftueshëm me notat 5 dhe 6

5

japin notën maksimale 7

Zonë informale

Mesatarja e përgjithshme e atyre që jetojnë në zonë informale është 3.57.

17

qytetarë japin notat më të ulëta 1 dhe 2

28

japin notën 3 dhe 4

11

notat 5 dhe 6

4

japin votën maksimale 7

Përgjigja sipas gjinisë- Meshkuj

Mesatarja e përgjithshme e meshkujve është 3.81.

24

prej tyre nuk e ndejnë kulturën evropiane në media

38

e ndejnë disi

20

besojnë mjaftueshëm

12

prej tyre e shohin plotësisht të pranishme

Femra

Mesatarja e përgjithshme e përgjigjeve për femrat është 3.77.

18

prej tyre japin vlerësim të ulët

45

mendojnë se ka disi

17

besojnë se është e mjaftueshme

6

prej tyre e shohin se e shohin plotësisht të pranishme

Përgjigja sipas arsimit- Fillor

Mesatarja e përgjithshme e përgjigjes të qytetarëve me arsim fillor është 2.83. Vlen të theksohet se janë vetëm 6 qytetarë me arsim fillor të anketuar.

Tetëvjeçar

Mesatarja e përgjithshme e përgjigjes të qytetarëve me arsim tetëvjeçar është 3.92. Vlerësimi me 4, pra disi e pranishme kultura evropiane në media, është dhënë nga 12 qytetarë, ose pjesa më e madhe e tyre.

I mesëm

Mesatarja e përgjithshme e përgjigjes të qytetarëve me arsim të mesëm është 3.65.

24

prej tyre nuk e ndejnë kulturën evropiane në media

36

prej tyre e vlerësojnë disi

19

e vlerësojnë mjaftueshëm

8

prej tyre japin vlerësim maksimal

Universitar


Mesatarja e përgjithshme e përgjigjes të qytetarëve me arsim universitar është 3.94. Vlen të theksohet se numri 4, pra me vlerësimin disi, është zgjedhur nga shumica prej 10 qytetarësh.

Pasuniversitar

Mesatarja e përgjithshme e përgjigjes të qytetarëve me arsim pasuniversitar është 4.14. Vlen të theksohet se **15** qytetarë gjithsej kanë qenë me arsim pasuniversitar. Gjysma e tyre ose **7** qytetarë kanë vlerësuar me notat 3 dhe 4.

P16. Përmendni, nëse njihni nga 1 deri në 3 prodhime të pavarura, që vijnë nga agjenci jo-mediatike?

Thumb	4
Rrathët	1
Çmendina Dublin	1
Publicus	1
Nuk njih	173



Siç duket edhe nga përgjigjet, qytetarët janë pothuaj aspak të informuar mbi prodhimet e pavarura në mediat audiovizive.

P17. Sa mendoni se vlerësohet "E drejta e autorit" në mediat shqiptare nga 1 deri në 7?

Mesatarja e përgjithshme është 3.4, pothuaj një përgjigje neutrale e plotë nga të pyeturit.

54 mendojnë se respektohet pak

80 mendojnë se respektohet disi

39 mendojnë se respektohet mjaftueshëm

7 mendojnë se respektohet

Përgjigja sipas zonës së banimit- Qendër

Mesatarja e përgjigjeve të qytetarëve që banojnë në qendër është **3.08.**

Periferi

Mesatarja e përgjigjeve të qytetarëve që banojnë në periferi është **3.65.**

Zonë informale

Mesatarja e përgjigjeve të qytetarëve që banojnë në zonë informale është **3.5.**

Përgjigja sipas gjinisë- Meshkuj

Mesatarja e përgjigjeve të qytetarëve të seksit meshkuj është **3.55.**

Femra

Mesatarja e përgjigjeve të qytetarëve të seksit femër është **3.25.**

Përgjigja sipas nivelit arsimor- Fillor

Mesatarja e përgjithshme e përgjigjes të qytetarëve me arsim fillor është **3.67.**

Tetëvjeçar

Mesatarja e përgjithshme e përgjigjes të qytetarëve me arsim tetëvjeçar është **3.67.**

I mesëm

Mesatarja e përgjithshme e përgjigjes të qytetarëve me arsim të mesëm është **3.53.**

I lartë

Mesatarja e përgjithshme e përgjigjes të qytetarëve me arsim të lartë është **2.82.**

Pasuniversitar

Mesatarja e përgjithshme e përgjigjes të qytetarëve me arsim pasuniversitar është **2.78.**

Sikurse duket nga përgjigjet, ka një lidhje mes nivelit arsimor dhe vlerësimit për respektimin e të drejtave të autorit në media. Më të arsimuarit besojnë se kjo e drejtë respektohet më pak në media.

P18. Mendoni se ka reklama të fshehura në mediat shqiptare?

120 qytetarë ose **67 %** e tyre mendojnë se po
24 qytetarë ose **13 %** e tyre mendojnë se jo
36 qytetarë ose **20 %** shprehen se nuk e dinë

Përgjigja sipas zonës së banimi

43 qytetarë ose **72%** e qytetarëve në qendër mendojnë se po
39 qytetarë ose **65%** e qytetarëve në periferi mendojnë se po
37 qytetarë ose **62%** e qytetarëve që jetojnë në zonë informale mendojnë se po

Përgjigja sipas gjinisë

58 qytetarë të gjinisë femërore ose **67 %** e tyre mendojnë se po
61 qytetarë të gjinisë mashkullore ose **65 %** e tyre mendojnë se po

Përgjigja sipas nivelit arsimor

3 qytetarë me arsim fillor ose **50 %** mendojnë se po
19 qytetarë me arsim tetëvjeçar ose **49 %** mendojnë se po
65 qytetarë me arsim të mesëm ose **67 %** mendojnë se po
26 qytetarë me arsim universitar ose **76 %** mendojnë se po
13 qytetarë me arsim pasuniversitar ose **93 %** mendojnë se po

Përgjigja sipas grupmoshës

Grupmosha 12-17;
12 prej tyre ose **44 %** mendojnë se po, **14 %** thonë jo dhe **41 %** nuk e di.

Grupmosha 18-34;
39 prej tyre ose **76 %** mendojnë se po, **14 %** thonë jo dhe **10 %** nuk e di.

Grupmosha 35-49;
46 % e tyre ose **74 %** mendojnë se po, **10 %** thonë jo dhe **16 %** nuk e di.

Grupmosha mbi 50;
22 prej tyre ose **55 %** mendojnë se po, **18 %** thonë jo dhe **28 %** nuk e di.

Nëse po, ku i gjeni më tepër? (mund të zgjidhni më shumë se një alternativë)

Edicion lajmesh	21 qytetarë ose 12%
Talk-Show	53 qytetarë ose 29%
Emision	77 qytetarë ose 45%
Programme për fëmijë	13 qytetarë ose 7%
Filma dokumentarë	11 qytetarë ose 6%
Ndeshje sportive	25 qytetarë ose 14%

P19. Reklamati, i konsideroni më tepër si: (zgjidhni një alternativë)

Informative	63 qytetarë ose 35%
Disinformuese	3 qytetarë ose 2%
Ndërhyrëse	40 qytetarë ose 22%
Të vërteta	3 qytetarë ose 2%
Të gënjeshtërtë	21 qytetarë ose 12%
Të panevojshme	23 qytetarë ose 13%
Të domosdoshme	27 qytetarë ose 15%

P20. Keni dëgjuar ndonjëherë për Këshillin e Ankesave, si njësi e Autoritetit të Mediave?

22

qytetarë ose 12 % shprehen se po

142

qytetarë ose 79 % mendojnë se jo

16

qytetarë ose 9 % mendojnë se kanë
dëgjuar përciptazi